



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



MNE - ALB

IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - SHQIPËRI 2014-2020


SIPËRMARRJA DHE VETËPUNËSIMI I TË RINJVE NË ZONËN NDËRKUFITARE SHQIPËRI-MALI I ZI:

*kushtet aktuale, perspektiva
dhe bashkëpunimi ndërkufitar*

RAPORT PËRFUNDIMTAR 2 0 2 1



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM



Ky raport është hartuar në kuadër të projektit Work4Youth të zbatuar nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, Shoqata për Prosperitet Demokratik - Zid dhe Intelektualët e Rinj “Shpresë”, në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Mali i Zi - Shqipëri 2014-2020 nën Instrumentin e Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA II) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e raportit është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e ekipit të studiuesve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

©Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Tiranë, Shqipëri 2021

Autorët:

IDRA Research & Consulting

*Donald Vullnetari
Lorena Kurti*

**Pavle Pavlović
Ana Marjanović**

Grafika dhe Faqosja:

Maris Selamaj

SIPËRMARRJA DHE VETËPUNËSIMI I TË RINJVE NË ZONËN NDËRKUFITARE SHQIPËRI-MALI I ZI:

*kushtet aktuale, perspektiva
dhe bashkëpunimi ndërkufitar*

RAPORT PËRFUNDIMTAR 2 0 2 1

PËRMBAJTJA

04

Lista e figurave

05

Lista e Tabelave

06

Përmbledhje ekzekutive

09

BE-ja dhe Ballkani Perëndimor

11

Pjesa 1: Studim nga Shqipëria

12

Hyrje

20

Rezultatet e Studimit

44

Konkluzione

46

Rekomandime

47

Pjesa 2: Studim nga Mali i Zi

48

Hyrje

49

Punësimi dhe sipërmarrja e të rinjve —
përkufizimi dhe metodologjia e përdorur

50

Studimi i Vetëpunësimit, Rinisë dhe
Sipërmarrjes në Mal të Zi

60

Rekomandime

61

Referenca

63

Shtojca

LISTA E FIGURAVE

- Figura 1: Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në qarkun e Shkodrës 2016 - 2019 (% e popullsisë +15 vjeç) **12**
- Figura 2: Shkalla e papunësisë në Shkodër 2016-2019 (%) **12**
- Figura 3: Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës në 2019 (në % e popullsisë +15 vjeç) **13**
- Figura 4: Shkalla e papunësisë për vitin 2019 me rajone (%) **13**
- Figura 5: Numri i sipërmarrjeve dhe përqindja e sipërmarrjeve me mbi 5 punonjës sipas rajonit, 2019. **14**
- Figura 6: Bizneset aktive sipas aktivitetit ekonomik, 2019. **14**
- Figura 7: Shpërndarja e të anketuarve sipas moshës. **20**
- Figura 8: Shpërndarja e të anketuarve sipas gjinisë. **20**
- Figura 9: Veprimtari edukative më të fundit. **21**
- Figura 10: Aktualisht në studim – shpërndarja e nivelit të arsimimit (N=75) **21**
- Figura 11: Arsimi i përfunduar ose i lënë –shpërndarja e nivelit të arsimit (N=125) **21**
- Figura 12: Shpërndarja e të anketuarve sipas arsimit. **22**
- Figura 13: Cila nga aktivitetet e mëposhtme korrespondon më mirë me aktivitetin e menjëhershëm pas përfundimit të nivelit tuaj arsimor?. **22**
- Figura 14: Përqindja e të rinjve që kanë punuar (ose aktualisht punojnë) gjatë studimeve të tyre. **23**
- Figura 15: Përqindja e studentëve që punojnë që janë paguar ose paguhen për punën e tyre. **23**
- Figura 16: Cila nga cilësitë e mëposhtme mendoni se është më e dobishme për të gjetur një punë të mirë?. **24**
- Figura 17: Në mënyrë ideale, cilin nga llojet e mëposhtme të punës do të preferonit?. **25**
- Figura 18: Javën e fundit cili ka qenë aktiviteti juaj kryesor?. **25**
- Figura 19: Çfarë planifikoni të bëni pas përfundimit të programit aktual të arsimit/formimit?. **26**
- Figura 20: Si keni ndërmend të kërkonit një punë?. **26**
- Figura 21: Perceptimet e të rinjve në arsim mbi kapacitetin e punësimit të aftësive të tyre në sipërmarrje. **27**
- Figura 22: Çfarë e përshkruan më mirë pozicionin tuaj?. **28**
- Figura 23: Gjatë katër javëve të fundit, a keni ndërmarrë ndonjë hap për të gjetur punë ose për të krijuar biznesin tuaj? **28**
- Figura 24: Çfarë hapash keni ndërmarrë për të kërkuar punë gjatë katër javëve të fundit?. **28**
- Figura 25: Cila është arsyeja kryesore që nuk keni kërkuar punë gjatë katër javëve të fundit?. **28**
- Figura 26: Cila ka qenë pengesa kryesore në gjetjen e një pune të mirë?. **29**
- Figura 27: Situata e kontratës së punës. **30**
- Figura 28: Përqindja e të rinjve që kanë një kontratë pune formale – sipas zonave urbane dhe gjinisë. **30**
- Figura 29: Niveli i kënaqësisë me punën aktuale – i ndarë sipas formalitetit të kontratës. **31**
- Figura 30: Arsytet për të qenë të kënaqur me punën aktuale. **31**
- Figura 31: Arsytet për të qenë të pakënaqur me punën aktuale. **31**
- Figura 32: Synimi për të ndryshuar vendin e punës. **32**
- Figura 33: Duke menduar për 12 muajt e ardhshëm, sa mund të besoni se do të jeni në gjendje të mbani punën tuaj kryesore nëse dëshironi?. **32**
- Figura 34: A keni menduar ndonjëherë të bëheni një sipërmarrës?. **40**
- Figura 35: Përqindja e të rinjve që mendojnë të bëhen sipërmarrës – sipas zonave urbane, gjinisë, grupmoshës dhe arsimit **40**
- Figura 36: Çfarë mendoni se do t'ju ndihmonte të arrini synimin tuaj sipërmarrës?. **41**
- Figura 37: Pse nuk mendoni të bëheni një sipërmarrës?. **41**
- Figura 38: Vlerësimi i dimensioneve të mjedisit sipërmarrës. **42**

LISTA E TABELAVE

Table 1: Shpërndarja e të intervistuarve. **20**

Table 2: Preceptim mbi nivelin e arsimit/trajnimit të nevojshëm për të gjetur një punë të mirë këto ditë – sipas nivelit aktual të arsimit. **23**

Table 3: Përmbajtja institucionale e bashkive Tivar, Podgoricë dhe Tuz. **52**

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky studim është kryer në kuadër të projektit Work4Youth, zbatuar në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Mali i Zi - Shqipëri 2014-2020 me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Zonat e synuara janë Qarku i Shkodrës në Shqipëri si edhe Bashkitë e Tivarit, Tuzit dhe Podgoricës në Malin e Zi. Qëllimi i studimit është të analizojë situatën ekzistuese dhe të eksplorojë mundësitë për përmirësime në mjedisin që mundëson punësimin dhe vetëpunësimin e të rinjve në këto zona të synuara.

Gjetjet kryesore nga ky studim dëshmojnë se zonat e qarkut të Shkodrës në Shqipëri dhe në bashkitë e Tivarit, Podgoricës dhe Tuzit në Mal të Zi paraqesin potencial të pashfrytëzuar për bashkëpunim. Këto zona karakterizohen tradicionalisht nga shkëmbimi i madh i mallrave dhe shërbimeve, nga matrica e ngjashme kulturore që për shekuj i ka tejkaluar ndonjëherë edhe mosmarrëveshjet zyrtare shtetërore. Sot ato përballen me të njëjtat probleme si nga ana e sistemit ashtu edhe në aspektin e përfshirjes së të rinjve, si burim i pavlerësuar në mënyrën e duhur në lidhje me kapërcimin e sfidave ekonomike dhe sociale. Niveli i lartë i korrupsionit, nepotizmi, hendeku mes të moshuarve dhe të rinjve, përfaqësojnë vetëm disa nga aspektet që janë në themel të këtij problemi. Gjithashtu, migrimet e mëdha, brenda dhe ndërmjet vendeve, kanë ndikim të konsiderueshëm në këtë zonë ndërkufitare dhe kërcënojnë perspektivën e saj. Këto boshllëqe të mbetura peng e zgjidhjeve institucionale të pamjaftueshme, kanë nevojë thelbësore për një politikë që do të ofronte një balancë të mirë midis ofertës dhe kërkesës. Ndonëse njësitë e qeverisjes vendore e njohin rëndësinë e problemit, të rinjtë kanë tendencë të kenë perspektiva të ulëta për shkak të paaftësisë së institucioneve për të zgjidhur këtë problem dhe për shkak të buxheteve modeste.

Niveli i lartë i papunësisë dhe pasiviteti i të rinjve mbeten ndër sfidat më imediate, duke kufizuar perspektivat për zhvillime të mëtejshme të tregut të punës. Tregu i punës dominohet nga sipërmarrjet e vogla dhe të mesme, të cilat edhe pse kanë një kontribut të konsiderueshëm si në rritjen ekonomike ashtu edhe në punësim, ofrojnë potencial të kufizuar për krijimin e vendeve të punës. Për më tepër, nivelet e konsiderueshme të informalitetit krijojnë deformim të tregut të punës dhe pengojnë krijimin e vendeve të reja të punës. Të rinjtë mbeten jashtë fuqisë punëtore kryesisht për shkak të barrierave për pjesëmarrje, siç është mungesa e vendeve të punës, mospërputhja ndërmjet nivelit të aftësive dhe vendeve të punës që ofrohen, pagat e ulëta dhe kushtet e pafavorshme të punës. Kjo rezulton në problematikë më të madhe për papunësinë afatgjatë, duke sjellë si pasojë të rinj të dekurajuar që braktisin tregun e punës, trajnimet dhe zhvillimin e aftësive, dhe shpesh kanë tendencën të migrojnë.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm në lidhje me tregun e punës është edhe përputhshmëria ndërmjet ofertës dhe kërkesës. Shumica e të rinjve kërkojnë një punë duke kërkuar ndihmë nga miqtë dhe të afërmit, ndërsa kanale të tjera dhe disi më formale janë praktikisht jashtë fokusit. Kanalet e përfshira janë teorikisht të gjitha llojet e ndërmjetësimit ndërmjet ofertës dhe kërkesës për punë. Ndërmjetësuesit e tregut të punës luajnë një rol të rëndësishëm në ndërtimin e rrjeteve dhe reduktimin e kostove të transaksionit, në ndikimin dhe minimizimin e mospërputhjeve si nga aspekti i punëkërkuesve ashtu edhe nga punëdhënësit, si edhe në inkurajimin e individëve të paangazhuar për t'u përfshirë në tregun e punës. Mungesa dëshmon për një lidhje shumë të brishtë midis ofertës dhe kërkesës për punë në këtë rajon.

Papunësia është gjithashtu e lidhur ngushtësisht me sistemin arsimor. Politikat arsimore e adresojnë këtë problem në mënyrë të pamjaftueshme dhe pa strategji të mirëfilltë. Kuotat e tepërta të regjistrimit, “përqendrimi” rajonal i institucioneve arsimore dhe “zhdukja e arsimit” në rajone të caktuara përbëjnë vetëm disa nga problemet në këtë sektor. Pavarësisht faktit se kanë një diplomë, shumë të rinj mbeten të papunë për shkak të mungesës së aftësive praktike ose për arsye se aftësitë e tyre nuk përputhen me kërkesat e tregut të punës. Në përgjithësi, kurrikulat universitare janë të vjetruara dhe përgjithësisht teorike. Për këtë arsye, kurrikulat universitare duhet të përshtaten me nevojat e tregut dhe universitetet duhet të punojnë më ngushtësisht me sektorin privat për të përditësuar kurrikulat e tyre. Ky aspekt do të mund të zgjidhej me orë mësimi praktike, por edhe me eksperiencë që do të vinte nga brezat me më shumë përvojë, si në aspektin e organizimit dhe të realizimit të punës edhe në krijimin e bizneseve të tyre në mënyrë të pavarur. Kjo do të zvogëlonte hendekun mes gjeneratave dhe nga ky bashkëpunim do të mund të plotësoheshin të dyja kategoritë në raport me dobësitë që kanë.

Sipërmarrja rinore në rajon është ende e përgjumur, por ka iniciativa dhe indikacione ndryshimi që mund të shkojnë në një drejtim më produktiv. Aktiviteti sipërmarrës është i fokusuar kryesisht në aktivitetet e sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme me disa raste suksesesh afatgjata. Pandemia aktuale ka diktuar tendencat e biznesit që disa kompani kanë përdorur për t'u përgatitur për periudhën në vijim. Megjithatë, pavarësisht nga ekzistenca e më shumë mundësive, është e nevojshme të krijohet një mjedis novator biznesi për perspektiva të mëtejshme rritjeje. Sfidat kryesore për mjedisin e sipërmarrjes rinore përfshijnë mjedisin e pafavorshëm të biznesit, mungesën e vizionit dhe qasjes në financa. Të rinjtë zakonisht janë të pasigurt për kuadrin tatimor dhe ligjor, ndërkohë që ky kuadër duket i ndërlikuar dhe dekurajues. Më tej, megjithëse ekziston një narrativë e përgjithshme për sektorët e zhvillimit strategjik (si turizmi, bujqësia ose TIK), mungon orientimi domethënës se cilat janë mundësitë specifike në këto fusha, ndërkohë që të rinjtë e kanë të vështirë të kërkojnë këto mundësi. Qasja në financa është

padryshim një sfidë e madhe për sipërmarrjen rinore në zonë, për sipërmarrjet në fazat e hershme. Edhe pse ka mundësi në rritje për grante, të financuara nga donatorët ndërkombëtarë dhe në bashkëpunim me qeverinë, ato mbështetje financiare janë shumë të vogla ose nuk ka vazhdimësi në asistencë financiare, kështu që jetëgjatësia e *start-up*-ve është afatshkurtër. Gjithashtu, kjo çështje kryesisht nuk mbështetet me skemat e duhura të mentorimit dhe monitorimit, duke i lënë start-up-et ose të dështojnë vetë, ose ta konsiderojnë grantin si fitim dhe të mbyllin aktivitetin.

Natyrisht një perspektivë më e zgjeruar do të kërkonte rrjetëzimin e të gjithë aktorëve të përfshirë në çështjen e punësimit dhe sipërmarrjes së të rinjve, sepse gjetjet e studimit dëshmojnë se edhe në nivel kombëtar, rrjetëzimi dhe qasja shumë-sektoriale kanë dështuar dhe kryesisht mungojnë. Kjo do të tejkalonte problemin e vendosjes në treg të produkteve si dhe problemin e transparencës dhe qasjes ndaj informacionit të nevojshëm për zbatimin e proceseve të vetëpunësimit. Strukturat ekzistuese, si dhomat e tregtisë dhe rrjetet e tjera të biznesit duhet të jenë një pikë fokale në mbështetjen e zhvillimit të sipërmarrjes rinore. Rrjetet e biznesit mund të jenë të vlefshme për sipërmarrësit e rinj në mënyrë që të rriten dhe zgjerohen. Ata kanë përvojën, njohuritë dhe rrjetin operacional, të cilat mund të jenë thelbësore për sipërmarrësit në fazën e tyre fillestare dhe gjatë gjithë ciklit të tyre jetësor.

Gjithashtu, duke pasur parasysh trashëgiminë e përbashkët ideologjike të së kaluarës, vendet pjesëmarrëse në këtë projekt duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje promovimit të sipërmarrjes rinore dhe mobilizimit të tyre, gjë që do të krijonte parakushte për ndryshimin e sfondit kulturor dhe shpërndarje më të madhe të idesë së sipërmarrjes ndërmjet të rinjve. Pavarësisht dëshirës së një numri të caktuar të rinjsh për të filluar biznesin e tyre, ndërgjegjësimi i përgjithshëm për mundësitë e sipërmarrjes është i ulët në të dy vendet. Organizatat që specializohen në mbështetjen e sipërmarrësve të rinj kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur në shpërndarjen e përfitimeve të mundshme të sipërmarrjes së një biznesi dhe fushat e mundshme për ta bërë këtë.

Bashkëpunimi në nivel lokal ndërmjet komuniteteve lokale të dy vendeve është një parakusht i mirë dhe një potencial i pashfrytëzuar për përmirësimin e vetëpunësimit dhe sipërmarrjes së të rinjve në këtë rajon që do të ndikonte në problemin e papunësisë. Në këtë mënyrë, ky rajon, i cili preket nga shkalla e lartë e papunësisë tek të rinjtë, do të inkurajohet të përparojë në këndvështrimin ekonomik përmes dinamikës dhe rrjetëzimit të ndërsjellë.

BE-JA & BALLKANI PERËNDIMOR^[1]

Një nga sfidat më të mëdha të politikave të dekadës së fundit për shumë shtete anëtare të Bashkimit Evropian (BE) (dhe shtetet jo-anëtare në OECD - Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik) ka qenë kriza e papunësisë tek të rinjtë. Në BE, shkalla e papunësisë së të rinjve arriti kulmin në vitin 2013 në 23.7%, por ajo arriti nivele shumë më të larta në disa shtete anëtare si Greqia (58.3%), Spanja (55.5%) dhe Kroacia (50.0%). Në Itali, shkalla e papunësisë tek të rinjtë arriti kulmin një vit më vonë në 42.7%. Në të njëjtën kohë, numri i të rinjve që nuk ishin në marrëdhënie pune, arsim apo trajnim (d.m.th. NEET) po rritej gjithashtu me shpejtësi (OECD, 2019).

Kur menduam se po fillonim të shpëtonim nga kriza, lindi një krizë e re e shkaktuar nga pandemia e COVID-19. Kjo krizë çon në shfaqjen e të ashtuquajturit "brezi i izolimit" dhe godet perspektivat e punës së të rinjve (News Parlamenti Evropian, 2020). Sipas Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO, 2020) pandemia po sjell një ndikim "shkatërrues dhe joproporcional" në punësimin e të rinjve, ndërsa shifrat më të fundit dëshmojnë se të rinjtë përballen me pengesa të mëdha në vijimin e formimit profesional dhe arsimimit, lëvizjen mes vendeve të punës dhe integritit në tregun e punës. Para pandemisë, shkalla e papunësisë së të rinjve në BE (15-24 vjeç) ishte 14.9%, një shifër më e ulët nga kulmi i saj 24.4% i cili u arrit në 2013. Në gusht 2020, shkalla e papunësisë u rrit në 17.6% dhe pritet të vijojë të rritet (lajmet nga faqja zyrtare e Parlamentit Evropian, 2020).

Eksplorimi i natyrës së punës që ata bëjnë si dhe perspektivat e reja që mund të vërehen duke ndjekur tendencat që u shfaqën gjatë kësaj krize, mund të shërbejnë si një bazë e mirë për perspektiva të reja për punësimin e të rinjve. Për shembull, studime të shumta sugjerojnë se njerëzit që fillojnë një biznes shpesh e bëjnë këtë në një fazë të mëvonshme të jetës dhe pasi kanë fituar një përvojë të vlefshme profesionale. Përgjithësisht, individët më të maturuar në krahasim me ata më të rinj kanë më shumë gjasa të jenë të vetëpunësuar, dhe meshkujt kanë më shumë gjasa të jenë të vetëpunësuar në raport me gratë (OECD, 2012). Ky rezultat konfirmohet plotësisht nga të dhënat e Eurostat-it, të cilat dëshmojnë se përqindja relative e të vetëpunësuarve tek të rinjtë që punojnë rritet me moshën, në veçanti, vetëm 4.2% e të rinjve të punësuar të grupmoshës 15-24 vjeç janë të vetëpunësuar, ndërsa kjo shifër rritet në 8.3% në mesin e atyre të moshës 25-29 vjeç dhe në 11.8% midis atyre të moshës 30-34 vjeç (Mascherini & Bisello, 2015). Në këtë drejtim, të vlefshme janë të dhënat e Eurostat-it për natyrën e biznesit që fillojnë të rinjtë. Ato janë kryesisht sipërmarrje të vogla dhe kanë më pak gjasa të punojnë me të punësuar sesa më të mëdhenjtë në moshë që janë të vetëpunësuar (OECD, 2013).

Të dhënat e Eurostat-it e konfirmojnë këtë fakt dhe dëshmojnë se bizneset e sipërmarrësve të rinj evropianë kanë më pak gjasa të kenë të punësuar sesa ato të grupmoshave të tjera. Ky hendek gjenealogjik ndodh shpeshherë si rezultat i një komunikimi më të dobët të kushtëzuar nga diskursi i ndryshëm i brezave, për shkaqe të ndryshmeve në aftësi, njohuri dhe pikëpamje në lidhje me sipërmarrjen. Megjithatë, gjasat janë që avancimi teknologjik që një grup i vogël njerëzish po merr me vete në një drejtim progresiv, lë mbrapa një shumicë që nuk di t'i përshtatë njohuritë e fituara me mjedisin dhe kulturën e re të sipërmarrjes në biznes.

Analizat e shteteve të Bashkimit Evropian në kombëtar e konfirmojnë këtë fakt dhe dëshmojnë se të rinjtë janë entuziastë për fillimin e sipërmarrjeve, por vetëm pak prej tyre e marrin iniciativën për biznes. Barrierat kryesore që prekin sipërmarrjen e të rinjve përfshijnë aftësitë, rrjetet dhe financimin e papërshtatshëm (Halabisky, 2012). Si zgjidhje, sipas përvojës së mëparshme rezulton se në një periudhë krize, politikat dhe programet publike për sipërmarrjen mund të luajnë një rol në adresimin e këtyre sfidave. Sipërmarrja rinore nuk është një kurë universale për zgjidhjen e problemit të papunësisë së të rinjve, por luan rol në lehtësimin e rrugës drejt tregut të punës për një grup të kufizuar të rinjsh me ambicie dhe mundësi për t'u bërë sipërmarrës. Por, mjedisi në nivel të BE-së në lidhje me politikat shtetërore kombëtare duhet ende të zhvillohet për sa i përket mbulimit, gjithëpërfshirjes dhe cilësisë që ofron (Halabisky, 2012).

Kështu, për shembull, raporti i përgatitur nga një grup autorësh që shqyrtojnë të mësuarit e sipërmarrjes në vendet e BE-së pasqyron të dhëna shqetësuese se pothuajse asnjë vend nuk ka të parashikuar një kuadër të gjerë strategjik për avancimin e të mësuarit të sipërmarrjes pavarësisht se ku zhvillohet mësimi. Nga ana tjetër, shumë vende kanë të parashikuar një strategji specifike, duke trajtuar shpesh mësimin e sipërmarrjes në arsimin formal tradicional. Zbatimi i këtyre strategjive është herë pas here sporadik dhe organizohet në institucionet arsimore tradicionale - si në shkolla, universitete, qendra arsimore dhe formimi profesional, klube rinore dhe qendra rinore - aktorë të ndryshëm kanë ide shumë të ndryshme se cilat objektiva mësimore duhet të ndiqen për të përmirësuar kompetencat sipërmarrëse dhe për mënyrën se si vlerësohen rezultatet e të mësuarit. Pa një konsensus për metodat më të përshtatshme për arritjen e këtyre objektivave, kjo hapësirë e dedikuar për këtë qëllim përkthehet në një të ardhme të panjohur që mund të rezultojë veçse e pashpresë në një kuadër të tillë (Andersen, Frøhlich Hougaard, Nindl, & Hill-Dixon, 2017).

[1] Ky seksion është hartuar dhe përgatitur si pjesë e studimit nga Mali i Zi

Meqenëse vetëm disa vende anëtare të BE-së kanë një strategji edukimi në lidhje me sipërmarrjen të integruar në të gjitha nivelet e sistemeve të tyre arsimore dhe shumë pak vende kanë një strategji kombëtare që pranojnë se të mësuarit e sipërmarrjes mund të zhvillohet në mjedise jo tradicionale dhe informale, duke përfshirë punën e të rinjve, Bashkimi Evropian ka ofruar një sërë dokumentesh me vizione strategjike për punësimin e të rinjve dhe sipërmarrjen në nivel ndërkombëtar. Strategjia Evropiane për Zhvillim dhe Punë 2020, Garancia për Rininë, Rekomandimi i Këshillit nga prilli 2013, investimi në Rininë Evropiane nga 2016, Korniza Evropiane e Kualifikimeve dhe praktikave cilësore e kështu me radhë, përfaqësojnë vetëm një pjesë të vogël të përpjekjeve të BE-së për të përmirësuar pozicionin e të rinjve në sipërmarrje. Të gjitha këto dokumente kanë këto objektiva të përbashkëta: adresimin e shqetësimeve të të rinjve në strategjitë e punësimit, investimin në aftësitë që punëdhënësit kërkojnë, zhvillimin e shërbimeve të orientimit dhe këshillimit në karrierë, promovimin e mundësive për të punuar dhe për tu trajnuar jashtë vendit, mbështetjen e praktikave/stazheve në nivele cilësore, përmirësimin e kujdesit për fëmijët dhe përgjegjësitë e përbashkëta familjare, të cilat inkurajojnë sipërmarrjen (Bashkimi Evropian, 2021). Sipërmarrja, papunësia, parandalimi i përjashtimit social dhe inovacioni midis të rinjve janë shpesh sinonime që synojnë të rinjtë dhe një perspektivë më të mirë për ta.

Kur bëhet fjalë për gjetjet e raportit të Bankës Botërore dhe Institutit të Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare (Grupi i Bankës Botërore, 2019) për Ballkanin Perëndimor rezulton se performanca e tregut të punës po përmirësohet, megjithëse me një ritëm më të ngadaltë se në vitet e mëparshme dhe pavarësisht rritjes së fortë ekonomike në këtë rajon. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si rezultat i vendeve të reja të punës të krijuara, të cilat janë shoqëruar me rritje të PBB-së në rajon nga 2.5% në 2017 në 3.9% në vitin 2018. Nga ky studim Shqipëria dhe Mali i Zi shënuan rritjen më të lartë të punësimit në rajon, me 3.3 për qind, e ndjekur nga Maqedonia e Veriut me 2.1 për qind. Shumica e vendeve të reja të punës janë krijuar në industri dhe në shërbime. Gratë mbetën të papërfaqësuar në tregjet e punës të Ballkanit Perëndimor, por nga ana tjetër rritja me më shumë se gjysmë e punësimit i preku ato. Megjithatë, papunësia mbetet një sfidë e rëndësishme në Ballkanin Perëndimor, pasi normat e papunësisë janë dy deri në tre herë më të larta se në vendet e BE-së (Grupi i Bankës Botërore, 2019).

Kjo rritje pozitive është cënuar nga kriza ekonomike e shkaktuar nga pandemia COVID-19 dhe ka ndikuar ndjeshëm që ekonomitë tashmë të brishta të Ballkanit të marrin një valë tronditjeje nga e cila do të duhet të dalin vetëm nëpërmjet strategjive ekonomike më novatore dhe kreative. Në vitin 2020, papunësia për popullsinë 15-24 vjeç ishte 35.1% në Ballkanin Perëndimor, më e ulëta ishte në Shqipëri (26.5%) dhe më e larta në Kosovë (49.1%). Mesatarja evropiane në këtë rast kur bëhet fjalë për papunësinë e të rinjve është 16.9% (Raičević, 2020).

Gjetjet aktuale mbi këto tema sugjerojnë se pengesat dhe kufizimet kryesore për të rinjtë që fillojnë biznes janë: sigurimi i kapitalit fillestar, mungesa e mbështetjes në mjedisin ku jetojnë, procedurat komplekse administrative, pamjaftueshmëria e qasjes në mbështetje dhe mentorim profesional, kohëzgjatja e kufizuar e programeve të drejtuara nga qeveria dhe organizatat joqeveritare (OJQ), mungesa e edukimit mbi sipërmarrjen, mungesa e kontakteve të biznesit mes të rinjve (Rovčanin, 2019). Një nga kufizimet më të mëdha të rajonit janë normat sociale, të cilat si pjesë përbërëse e çdo mjedisi sipërmarrës mund të inkurajojnë ose pengojnë sipërmarrjet e reja të biznesit. Megjithatë, ka një sasi të vogël të të dhënave për këtë çështje, kështu që çdo analizë e qëndrimit të shoqërisë ndaj sipërmarrjes, statusit të sipërmarrësve në shoqëri, qëndrueshmërisë së zgjedhjeve të karrierës për të rinjtë mund të jenë të rëndësishme për të kuptuar këtë çështje komplekse (Raičević, 2020).

Kur bëhet fjalë për kornizat strategjike në Ballkanin Perëndimor për çështjen e papunësisë së të rinjve, disa hapa pozitivë janë ndërmarrë në një kuptim strategjik. Në këtë drejtim ka edhe iniciativa dhe aktivitete të shumta projektsh në vendet të rajonit, por problemi më i madh që vazhdimisht prek të gjitha aktivitetet e projektit është mosvijimësia. Gjithashtu, kjo hapësirë karakterizohet nga një procedurë burokratike shpesh e ndërlikuar që mund të jetë vendimtare për fillimin e një biznesi. Sipërmarrësit e rinj po përballen me vështirësi për shkak të mungesës së informacionit rreth regjistrimit të një biznesi dhe legjislacionit që rregullon veprimtarinë e tyre. Çfarë është e favorshme për fillimin e një biznesi është se infrastruktura shpesh nuk është problem operimi, por mungesa e hapësirës ku të zhvillohen aktivitetet është. Gjithashtu, mbështetja administrative do të luante një rol kyç duke qenë se ekziston mungesa e njohurive rreth procedurave të caktuara, por edhe mbështetja mentoruese për trajnime më të mira duke konsideruar tendencat e biznesit.

Për më tepër, një nga pengesat më të mëdha për biznesin e pavarur në Ballkanin Perëndimor është mungesa e fondeve dhe vështirësitë në sigurimin e financimit. Ata kryesisht mbështeten te miqtë dhe te mbështetja e familjes. Kështu, për shembull në Bosnjë dhe Hercegovinë, shumica e të rinjve (nga 21-34 vjeç) që hapin biznesin e tyre ndihmohen nga familjet, të afërmit e tyre (Rovčanin, 2019). Më pas, sipas raportit të ILO-s (ONP - Organizata Ndërkombëtare e Punës), vetëm një në dhjetë persona të vetëpunësuar përdor një kredi për të nisur një biznes, dhe pothuajse gjysma (46.8%) e të anketuarve deklaruan se kishin marrë para hua nga familja ose miqtë, një e katërta (24.4%) kishte kursimet e tyre, dhe 19.5% thanë se nuk kishin nevojë për para (ILO, 2016). Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë shumë banka tregtare dhe institucione mikrokredie.

Të dhëna të ngjashme përsëriten në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe ajo që është paradoksale në këtë situatë është se shumica e vendeve kanë një numër të madh mundësish mikrokredie, por huatë që ofrojnë kryesisht nuk përfshijnë kushte dhe lehtësira të veçanta për të rinjtë që fillojnë biznesin e tyre të parë.

PJESA I: STUDIM NGA SHQIPËRIA

AUTORËT:

IDRA RESEARCH & CONSULTING

DONALD VULLNETARI

LORENA KURTI

Sfondi historik

Qëllimi i studimit është të analizojë situatën ekzistuese dhe të eksplorojë mundësitë për përmirësime në mjedisin që mundëson punësimin dhe vetëpunësimin e të rinjve në zonat e synuara me fokus në rajonin e Shkodrës. Fillimisht ne ofrojmë një sfond të shkurtër të tregut të punës në këtë rajon.

Gjatë viteve 2016 – 2019 dëshmohet një tendencë pozitive në të dy treguesit kryesorë të tregut të punës për qarkun e Shkodrës. Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore u rrit nga 58.3% në 63.0% (4.7 persona), ndërsa shkalla e papunësisë ka rënë ndjeshëm nga 12.8% në 9.4% (3.4 persona).

FIGURA 1: SHKALLA E PJESËMARRJES NË FUQINË PUNËTORE NË QARKUN E SHKODRËS 2016 - 2019 (% E POPULLSISË +15 VJEÇ)





FIGURA 2: SHKALLA E PAPUNËSISË NË SHKODËR 2016-2019 (%)




BURIMI: STUDIMI I FORCAVE TË PUNËS TË DHËNA: 2021

SHËNIM: TË DHËNAT VJETORE PËR VITIN 2020 NUK JANË ENDE TË DISPONUESHME NGA INSTAT

Krahasimisht, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është pak mbi mesataren e vendit, ndërkohë që ka disa qarqe që e tejkalojnë qarkun e Shkodrës në këtë aspekt. **(Figura 3)**. Shkalla e papunësisë është nën mesataren e vendit dhe krahasimi me rajonet e tjera sugjeron një treg konkurrues të punës **(Figura 4)**.


FIGURA 3: SHKALLA E PJESEMMARRJES NË FORCAT E PUNËS NË 2019 (NË % E POPULLSISË +15 VJEÇ)



BURIMI: ANKETA E FORCAVE TË PUNËS TË DHËNA: 2021

SHËNIM: TË DHËNAT VJETORE PËR VITIN 2020 NUK JANË ENDE TË DISPONUESHME NGA INSTAT

FIGURA 4: SHKALLA E PAPUNËSISË PËR VITIN 2019 SIPAS QARQEVE (%)




BURIMI: STUDIMI I FORCAVE TË PUNËS TË DHËNA: 2021

SHËNIM: TË DHËNAT VJETORE PËR VITIN 2020 NUK JANË ENDE TË DISPONUESHME NGA INSTAT

Në vitin 2019, në qarkun e Shkodrës ishin 10.999 sipërmarrje aktive, 8% e të cilave ishin sipërmarrje me mbi 5 punonjës (që shërbejnë si përfaqësuese për sipërmarrjet më të mëdha), duke sugjeruar një strukturë të dominuar nga sipërmarrjet e vogla.


FIGURA 5: NUMRI I SIPËRMARRJEVE DHE PËRQINDJA E SIPËRMARRJEVE ME MBI 5 PUNONJËS SIPAS QARQEVE, 2019



BURIMI: INSTAT - BAZA E TË DHËNAVE STATISTIKORE E REGJISTRIT TË BIZNESEVE, 2021

Për sa i përket aktivitetit ekonomik, ekziston një ekuilibër i dukshëm midis prodhuesve të mallrave dhe shërbimeve. Brenda kësaj strukture spikat bujqësia, pylltaria dhe peshkimi, pasi 40% e sipërmarrjeve i përkasin kësaj kategorie (kryesisht të fryra nga 'sipërmarrjet bujqësore' me një punonjës, të cilat nga viti 2015 përbëjnë pothuajse tërësisht fermerë të regjistruar me Numër Identifikimi Tatimor), e ndjekur nga aktiviteti tregtar me 26% të sipërmarrjeve, shërbime të tjera 13% dhe akomodimi dhe shërbimi ushqimor 12%.

FIGURA 6: BIZNESET AKTIVE SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK, 2019



BURIMI: INSTAT - BAZA E TË DHËNAVE STATISTIKORE E REGJISTRIT TË BIZNESEVE, 2021

SHËNIM: TOTALI = 10,999

Metodologjia e studimit


Komponenti sasior

Nëpërmjet metodës sasiore ne kemi realizuar 200 intervista me të rinjtë (nga 18 – 30) banues në qarkun e Shkodrës. Pyetësi është krijuar për të mbledhur informacione të përgjithshme – informacione personale, familjare dhe arsimimi, historia e aktiviteteve dhe aspiratat dhe më pas informacione relevante për aktivitetin aktual ekonomik të të anketuarit, synimet, angazhimet e mëparshme, etj. Qëllimi i pyetësit është të paraqesë një analizë të të rinjve të punësuar dhe të papunë. Nga këndvështrimi i të papunëve, analiza lidhet me detajet e kërkimit të punës (kohëzgjatja dhe mjetet) dhe perceptimi i të rinjve për pengesat që ata hasin në gjetjen e punës. Këtu parashikohen module specifike për të identifikuar veçanërisht pengesat me të cilat përballen në tregun e punës. Nga këndvështrimi i të punësuarve, ne eksplorojmë gjendjen e tyre aktuale në punë (vetë-përmbushja, kënaqësia, kushtet ekonomike) dhe perceptimet e tyre për tregun e punës.

Pyetësi synon të vlerësojë aftësitë e të gjithë të rinjve dhe të analizojë mundësitë e tregut me nivelin e aftësive.

Kampionimi, Metodologjia dhe Qasja

Metodologjia që përdoret është kampionimi i grupeve në shumë faza me shtresim. Ka disa faza që ndiqen:



Çdo fazë shpjegohet si më poshtë në detaje

Faza e parë: Përzgjedhja e njësisë primare të kampionimit

Njësia primare e kampionimit (NJPK) do të jenë Zonat e Regjistrimit (ZR)[2]siç përcaktohet nga Censusi i Popullsisë dhe Banesave. Njësia e analizës (*screening*) janë familjet e përzgjedhura në ZR. Për qëllime të kampionimit, ne përdorim si Njësi Primare të Kampionimit (NJPK) zonat gjeografike të përcaktuara nga qendrat e votimit. Këto zona të përcaktuara në mënyrë specifike në hartë do të shërbejnë si grupimi gjeografik i kampionimit. Duke qenë se një Qendër Votimi (QV) identifikon një zonë votimi, për lehtësinë e të shprehurit, në të gjithë këtë metodologji, "QV" ose "ZR" nënkupton zonat e votimit.

IDRA disponon bazën e të dhënave të QV-ve të Zgjedhjeve Parlamentare Qendrore të Shqipërisë 2017. Zonat gjeografike të përfaqësuara nga QV-të janë gjithëpërfshirëse dhe reciprokisht ekskluzive.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Shqipërisë (KQZ-AL) ka bërë publike edhe hartat e zonës që mbulon çdo QV. Çdo QV nuk mund të ketë më pak se 150 zgjedhës të regjistruar dhe jo më shumë se 1000 zgjedhës të regjistruar.

Studimi do të përdorë një probabilitet proporcional me përmasën (PPS) të shtresëzuar në dy faza dhe një metodologji kampionimi të rastësishëm për të arritur në një kampion përfaqësues. Faza e parë përbëhet nga një shtresëzim sipas rajoneve, urbane dhe rurale brenda çdo qarku, për shembull gjithsej 24 shtresa për Shqipërinë. Faza e dytë do të përdorë një metodologji PPS sipas numrit të familjeve në shtresa, për të zgjedhur ZR-të që mbulojnë diku nga 70-150 familje në njësitë bashkiake. Brenda ZR-ve, grupe prej 10 familjesh do të zgjidhen me kampionim të thjeshtë rastësor.

[2] Një **Zonë Regjistrimi** (ZR) është njësia statistikore më e vogël gjeografike e krijuar për censusin e popullsisë dhe banesave. Për shembull, një ZR mund të jetë një bllok qyteti, një fshat ose pjesë e një fshati, ose një grup fshatrash të vegjël. ZR ka kufij të mirëpërcaktuar të identifikuar në një hartë.

- Ne shtresuam njësitë e përzgjedhjes sipas rendit të mëposhtëm:
1. *Shtresëzimi sipas bashkive* – secila bashki konsiderohet si shtresë e veçantë. Numri i projektuar i ZR-ve përzgjidhet rastësisht për secilën shtresë.
 2. *Shtresëzimi sipas ndarjes urbane-rurale* – ZR-të e përzgjedhura për çdo rajon ndahen proporcionalisht me numrin e familjeve të vendosura në zonat e regjistrimit urban dhe rural për atë rajon specifik. Përqindjet mbi urbanizimin janë të verifikuara dhe kontrolluara me të dhënat e disponueshme për popullsinë për çdo rajon[3].

Probabilitet Proporcional me Masën

Për zgjedhjen e ZR-ve përdoret Moduli i kampionëve kompleksë të SPSS 25 së IBM. Ky modul i SPSS lejon shtresëzimin e tërthortë sipas rajonit edhe urbanizimit. Do të llogariten probabilitetet e përfshirjes në fazën e parë dhe peshat e kampionimit të fazës së parë.

Algoritmi i përdorur për zgjedhjen e zonave të regjistrimit është PPS-Sistematik (propabiliteti proporcional me masën (WOR[4]). Numri i popullsisë përdoret si MOS (Matja e Masës). Ky algoritëm u jep një shans më të lartë përzgjedhjeje atyre ZR-ve që kanë më shumë popullsi. Thënë ndryshe, zonat me popullsi më të lartë kanë një probabilitet më të madh për t'u përzgjedhur. ZR-të me një numër të vogël banorësh kanë gjithashtu një shans për përzgjedhje, por më të vogël se ZR-të “më të populluara”.

Procedura PPS preferohet nga teknikat e tjera të përzgjedhjes si “*kujt do që i bie lapsi*” ose siç njihet në komunitetin statistikor, Kampionimi i thjeshtë i rastësishëm. SRS i jep çdo NJPK-je një probabilitet të barabartë përzgjedhjeje, që do të thotë se grupimet e vogla kanë gjithashtu një shans 'të konsiderueshëm' për t'u përzgjedhur.

Kemi përdorur një shpërndarje proporcionale të intervistave, që do të thotë se në secilën komunë numri i intervistave do të jetë proporcional me përqindjen e popullsisë së komunës përkatëse. Ju lutemi vini re se një NJVK përbëhet nga 7 intervista.

Për të arritur një përmasë kampionimi prej 200 individësh, shpërndarja e kampionit përlllogaritet bazuar në shpërndarjen e mëposhtme:

Shpërndarja e Popullsisë

Bashkia	Urbane	Rurale	Totali
Fushë - Arrëz	1.4%	2.1%	3.4%
Malësi e Madhe	3.2%	13.2%	16.4%
Pukë	1.5%	3.1%	4.7%
Shkodër	35.0%	26.0%	61.0%
Vau i Dejës	0.7%	13.7%	14.4%
Totali	41.9%	58.1%	100.0%

[3] Të dhënat e censusit janë marrë në konsideratë, por do të konsultohen edhe burime të tjera.

[4] Pa zëvendësim. Kjo do të thotë që një ZA nuk mund të përzgjidhet dy herë.


16

Faza e dytë: Përzgjedhja e familjeve

Pasi të bëhet përzgjedhja e ZR-ve, vijon përzgjedhja e njësive të banimit. Për secilën nga ZR-të e përzgjedhura, ne konsiderojmë hartat (elektronike dhe kopje fizike) dhe përcaktojmë një pikënisje - një njësi që është lehtësisht e dallueshme dhe e aksesueshme. Secilës prej pikave fillestare të zgjedhura i shtojmë një distancë dhe drejtim të zgjedhur rastësisht. Kjo bëhet duke shtuar dy variabla Drejtimin dhe Distancën në bazën e të dhënave të ZR-ve të përzgjedhura.


Variabëli Distancë krijohet gjithashtu duke përdorur RV. Funkzioni i rastësishëm UNIFORM në SPSS SYNTAX (SEED është vendosur si i rastësishëm dhe përdoret gjeneratori i numrave Mersenne Twister) si funksion në SPSS SYNTAX. Kjo variabël merr vlerë që varion nga 1 në 6 të cilat janë etiketuar 1 = 0 metra, 2 = 50 metra, 3 = 100 metra, 4 = 150 metra, 5 = 200 metra dhe 6 = 250 metra. Distanca do të llogaritet duke marrë në konsideratë edhe kufijtë e Zonës së Regjistrimit.

Anketuesit/intervistuesit i[5] jepet harta e ZR-ve, pika e fillimit, drejtimi dhe distanca. Pasi anketuesi të gjejë pikën e nisjes, ai gjen drejtimin e dhënë dhe ecën në distancën e udhëzuar. Pas përshkueshmërisë së distancës së udhëzuar në drejtimin e dhënë, numëruesi lokalizon njësinë familjare më të afërt në atë pikë. Kjo konsiderohet si FILLIMI për përzgjedhjen e NJF-ve. (Ju lutemi shikoni foton më poshtë).



Pasi të arrihet FILLIMI, regjistruesi fillon të numërojë njësitë familjare. Anketuesi troket në çdo derë K-t[6] derë që ai sheh dhe llogarit numrin e caktuar të intervistave të skanuara në qendrën e votimit. Anketuesi përpiqet t'i afrohet të anketuarit vetëm në NJF-në e zgjedhur, d.m.th., në çdo derë të n-të sipas njësive të përzgjedhura.

- a) Nëse anketuesi kontakton anëtarin e kualifikuar të NJF, anketuesi prezantohet dhe përshkruan qëllimin e studimit dhe i kërkon të anketuarit të marrë pjesë.
- b) Nëse anketuesi kontakton një anëtar të NJF-së, përveç të kualifikuarit për intervistë, anketuesi bën një listë të anëtarëve të familjes që do të intervistohen dhe lë një takim. Anketuesi përpiqet të kontaktojë të anketuarin e kualifikuar edhe dy herë të tjera. Nëse nuk arrihet asnjë kontakt pas përpjekjes së tretë, familja konsiderohet e pasuksesshme. Kjo metodë quhet Metoda e kampionimit të rastësishëm. (Për një ilustrim me shembull, ju lutemi shihni diagramin e grafikut si më poshtë; intervali i përzgjedhjes K=3).
- c) Nëse nuk ka përgjigje nga NJF në përpjekjen e parë, anketuesi shënon adresën e NJF dhe përpiqet të kontaktojë një anëtar të NJF edhe dy herë të tjera.



[5] Këto terma do të përdoren në mënyrë të ndërsjellë dhe të dyja i referohen punonjësit që kryen analizën
[6] Intervali i përzgjedhjes do të jetë në korrelacion me numrin e familjeve të vendosura në zonën gjeografike të ZA-ve

Faza e tretë: Përzgjedhja e të anketuarit

Kur zgjidhet NJF, anketuesi liston të gjithë anëtarët e familjes nga 18 deri në 30 vjeç me të dhënat e ditëlindjes dhe gjininë e tyre. Renditja e të gjithë anëtarëve të familjes nga 18 deri në 30 vjeç ofron mundësinë e aplikimit të metodës së përzgjedhjes së të anketuarve. Anketuesi zgjedh anëtarin e familjes që ka ditëlindjen më të fundit nga dita e intervistës. Anketuesi nuk mund të intervistojë më shumë se një të anketuar për familje.

Metoda e mbledhjes së të dhënave (CAPI)

IDRA përdor teknologjinë Elektronike të Mbledhjes së të Dhënave për procesin e mbledhjes së të dhënave: të gjitha intervistat si të “ *Screener Survey*” (Studimi i Analizuesit) ashtu edhe të “*Main Surveys*” (Studimi kryesore) u kryen nëpërmjet CAPI (Intervista Personale me Ndihmën e Kompjuterit). IDRA disponon të gjitha mjetet, pajisjet dhe kapacitetet e nevojshme për të kryer intervista nëpërmjet EDC.

Skenarët që përcaktojnë formularin e hyrjes kryejnë automatikisht kontrolle logjike dhe kontrolle të konsistencës dhe njoftojnë menjëherë anketuesit për çështjet e mundshme.

Gjatë procesit dhe pas fazës së vendosjes së të dhënave, të dhënat e pyetësorit i nënshtrohen pesë llojeve të kontrolleve:

- a) Kontrollet e fashave,
- b) Kontrollet ndaj të dhënave të referencës,
- c) Kontrollet e kapërcimit,
- d) Kontrollet e konsistencës dhe,
- e) Kontrolle tipografike

a. **Kontrollet e fashave** synojnë të sigurojnë që çdo variabël në studim përmban vetëm të dhëna brenda një fushe të kufizuar vlerash të vlefshme. Variablat kategorikë mund të kenë vetëm një nga vlerat e paracaktuara për to në pyetësor (për shembull, gjinia mund të kodohet vetëm si 1 për meshkujt ose 2 për femrat); Variablat kronologjikë duhet të përmbajnë data të vlefshme dhe variablat numerikë duhet të qëndrojnë brenda vlerave minimale dhe maksimale të përcaktuara (si p.sh. 0 deri në 95 vjeç për moshën.)

b. Një rast i veçantë i kontrollit të fashave ndodh kur të dhënat nga dy ose më shumë fusha të lidhura ngushtë mund të **kontrollohen kundrejt** tabelave të jashtme të referencës, siç është për shembull rasti i *Konsistencës së rajoneve gjeografike*.

c. **Kontrolli i Kapërcimeve**. Këto kontrolle verifikojnë nëse modelet e kapërcimit janë ndjekur siç duhet. Në varësi të moshës dhe gjinisë së tij, çdo i anketuar supozohet të përgjigjet (ose të anashkalojë) pjesë të veçanta të pyetësorit.

d. **Kontrollet e konsistencës**. Këto kontrolle verifikojnë që vlerat nga një pyetje janë në përputhje me vlerat nga një pyetje tjetër. Një kontroll i thjeshtë kryhet kur të dyja vlerat janë nga e njëjta njësi statistikore, për shembull, data e lindjes dhe mosha e një individi të caktuar.

e. **Kontrolle tipografike**. Procedurat e kontrollit total dhe shifrave kryhen kur është e mundur.

Përdorimi i tabletave ka edhe garanci të tjera të cilësisë së të dhënave. Ky përdorim lejon një rritje të cilësisë dhe shpejtësisë së procesit të punës me lehtësi, ndër të tjera, si:

- Regjistrimi automatik në sistem i orës dhe datës së intervistës.
- Funksioni i gjeovendosjes lejon regjistrimin dhe gjurmimin e vendndodhjes së intervistës dhe duke sjellë një paraqitje grafike të secilit pyetësor në punën në terren (duke kontrolluar gjithashtu nëse intervistat po kryhen në njësinë primare të kampionimit).
- Menaxhimi i kohëzgjatjes së intervistës (asnjë pyetje nuk mund të anashkalohej pa përgjigje).

Për shkak të situatës pandemike të COVID-19 intervistat ballë për ballë me kampionimin primar dhe shtesë mund të rezultojnë të parealizueshme dhe IDRA është në gjendje që në vend të intervistave me pjesëmarrje fizike të aplikojë metodën CATI (Intervistat Personale me Ndihmën e Kompjuterit). IDRA ka kapacitetet e nevojshme (burimet logjistike dhe praktike: Platforma dhe stafi CATI) për të zbatuar projektin nëpërmjet CATI, që do të thotë se intervistat do të kryhen nëpërmjet intervistave telefonike. Megjithatë, IDRA preferon të përdorë metodën CAPI për këtë studim. CATI do të përdoret vetëm nëse situata e pandemisë e bën intervistimin ballë për ballë një opsion të pamundur.

Komponenti cilësor

Për të eksploruar më tej dinamikën e mjedisit të punësimit tek të rinjtë, puna kërkimore cilësore ofron njohuri thelbësore. Prandaj, ne kryem:

2 Fokus Grupe (FG) - Përfaqësues të të rinjve. Nëpërmjet dy FG ne synojmë të eksplorojmë dinamikën e tregut përmes sipërmarrësve të rinj dhe sipërmarrësve aspirues. Kryerja e kësaj ndarjeje sjell njohuri të vlefshme për të dyja këndvështrimet, pasi nga njëra anë ne

- eksplorojmë perceptimin e dinamikës së punësimit nga të rinjtë tashmë në tregun e punës dhe nga ana tjetër nga të rinjtë jashtë tregut të punës.
- **12 Intervista të Thelluara (ItD)** –përfaqësues të biznesit, dhomës së tregtisë, pushtetit vendor, organizatave rinore. Kemi kryer 12 ItD mbi perceptimin nga ana e ofertës ose aktorët përkatës të tregut. Fokusi i intervistave përqendrohet në njohuritë e tyre mbi zhvillimin e tregut të punës, veçanërisht për të rinjtë, përmes eksplorimit të potencialeve të ndryshme të industrisë dhe asaj që mungon në zhvillimin e kësaj industrie si sektorë kyç të shquar të punësimit dhe sipërmarrjes.

Shih **Shtojca 5**, **Shtojca 6** dhe **Shtojca 7** për më shumë detaje në lidhje me pjesëmarrësit.

Metodologjia për Komponentin Cilësor

Fokus Grupet (FG)

Përvoja jonë nga studimet e mëparshme dëshmon se shumë nga rezultatet e marra nga anketimi sasior kishin nevojë për shpjegime më të thella për t'u konsideruar dhe kuptuar drejt.

Atributet ose karakteristikat specifike të Fokus Grupeve do të vendosen në bashkëpunim të ngushtë me klientin. Faktorët përkatës për grupe të ndryshme janë, për shembull, mosha dhe gjinia, arsimi dhe statusi i punësimit.

Intervistat e thelluara (ItD)

Ka çështje që kanë nevojë për eksplorim të mëtejshëm dhe kuptim më të thellë për të kuptuar tablonë e plotë, ndaj IDRA planifikon të zhvillojë edhe intervista të thelluara me përfituesit. Intervistat e thelluara janë një metodë cilësore e mbledhjes së të dhënave që përfshin angazhim të drejtpërdrejtë, një me një me pjesëmarrësit individualë. Në këto intervista pjesëmarrësit inkurajohen dhe nxiten të flasin në thellësi rreth temës në studim pa përdorur nga studiuesi pyetje të paracaktuara, të fokusuara dhe me përgjigje të shkurtër. Duke përdorur ItD ka një cilësi më të lartë të kampionimit në krahasim me disa metoda të tjera të mbledhjes së të dhënave. Për më tepër, intervistat e thelluara mund të jenë potencialisht aq perceptuese, saqë është e mundur të identifikohen shumë shpejt gjetjet shumë të vlefshme. Si avantazhe të tjera, në ItD studiuesi:

- mund të krijojë marrëdhënie me pjesëmarrësit për t'i bërë ata të ndihen më komod dhe të qetë, gjë që mund të gjenerojë përgjigje më të thella - veçanërisht në lidhje me temat delikate.
- mund të ketë shumë më tepër mundësi për të bërë pyetje vijuese, për të hetuar për informacion shtesë dhe për t'ju kthyer pyetjeve kyçe më vonë gjatë intervistës për të gjeneruar një kuptim më të pasur të qëndrimeve, perceptimeve, motivimeve, etj.
- mund të monitorojë ndryshimet në tonin dhe zgjedhjen e fjalëve për të marrë një kuptim më të thellë (studiuesit mund të fokusohen gjithashtu në gjuhën e trupit).

Profili, Edukimi dhe Aftësitë

Bazuar në metodologjinë e studimit të përshkruar për shpërndarjen e intervistave proporcionalisht me madhësinë e bashkisë, **Tabela 1** tregon numrin e intervistave (dhe përqindjen) në secilën prej bashkive të qarkut Shkodër.


TABELA 1: SHPËRNDARJA E INTERVISTAVE

Bashkia	Nr. i intervistave	Përqindja e intervistave
Shkodër	109	55%
Pukë	20	10%
Fushë – Arrez	14	7%
Malësi e Madhe	28	14%
Vau i Dejës	29	15%
Totali	200	100%

BURIMI: ANALIZA E IDRA


Duke marrë parasysh kampionin e rastësishëm të popullatës rinore, është monitoruar shpërndarja e moshës dhe gjinisë për të siguruar përfaqësimin e duhur të të gjitha grupmoshave nga 18 deri në 30 vjeç si dhe një përfaqësim të barabartë të gjinisë. Bazuar në këtë, në **Figura 7** ne grupojmë grupmoshën në tre kategori për t'i përdorur në analizën tonë të mëtejshme, ndërsa **Figura 8** tregon shpërndarjen e të anketuarve sipas gjinisë.

FIGURA 7: SHPËRNDARJA E TË ANKETUARVE SIPAS MOSHËS




BURIMI: ANALIZA E IDRA

FIGURA 8: SHPËRNDARJA E TË ANKETUARVE SIPAS GJINISË




Të pyetur për aktivitetin e tyre të fundit arsimor, shumica e të rinjve deklaruan se kanë përfunduar arsimin (58%), ndërkohë që 38% e tyre janë aktualisht në studime, ndërsa niveli i braktisjes së studimeve është relativisht i ulët në 5%. Bazuar në këtë informacion, **Figura 9** dhe **Figura 10** shfaqin shpërndarjen e të rinjve sipas niveleve të arsimit, bazuar në përfundimin e nivelit të arsimit të tyre (edhe nëse e kanë braktisur) ose nëse janë duke ndjekur aktualisht.

FIGURA 9: VEPRIMTARI EDUKATIVE MË TË FUNDIT




BURIMI: ANALIZA E IDRA

FIGURA 10: AKTUALISHT NË STUDIM - SHPËRNDARJA E NIVELIT TË ARSIMIMIT (N=75)




BURIMI: ANALIZA E IDRA

FIGURA 11: ARSIMI I PËRFUNDUAR OSE I LËNË -SHPËRNDARJA E NIVELIT TË ARSIMIT (N=125)



Duke marrë parasysh të dyja shpërndarjet, **Figura 12** dëshmon shpërndarjen e përgjithshme të kampionit sipas arsimit. Shumica e kampionit përbëhet nga të rinjtë që kanë përfunduar (ose janë duke ndjekur) një shkollë të mesme ose profesionale (48%), të ndjekur nga të rinjtë që kanë përfunduar (ose janë duke ndjekur) arsimin e lartë ose studimet pasuniversitare (41%), dhe një përqindje e vogël që kanë përfunduar shkollën fillore (11%).


FIGURA 12: SHPËRNDARJA E TË ANKETUARVE SIPAS ARSIMIT



BURIMI: ANALIZA E IDRA

Rezultatet dëshmojnë se pothuajse gjysma e të rinjve që kanë përfunduar arsimin e tyre, kanë filluar menjëherë një punë (46%) – ndërsa sa më i lartë të jetë niveli i arsimit të përfunduar, aq më e madhe është shifra, veçanërisht 60% për ata që kanë përfunduar arsimin e lartë ose studimet pasuniversitare, 44% për ata që kanë përfunduar arsimin e mesëm ose shkollën profesionale dhe vetëm 27% për ata që kanë përfunduar arsimin fillor (shih **Shtojca 1**).
Më tej, vetëm 6% kanë filluar biznesin e tyre menjëherë pas përfundimit të arsimit, duke sugjeruar se kalimi nga shkolla në sipërmarrje është dukshëm i vështirë në këtë zonë.

FIGURA 13: CILA NGA AKTIVITETET E MËPOSHTME KORRESPONDON MË MIRË ME AKTIVITETIN E MENJËHERSHËM PAS PËRFUNDIMIT TË NIVELIT TUAJ ARSIMOR?



BURIMI: ANALIZA E IDRA

SHËNIM: VETËM ATA QË KANË PËRFUNDUAR ARSIMIN E TYRE - N=125

Shkalla e të rinjve që punojnë gjatë studimeve është mjaft e ulët, pasi vetëm 1 në 5 e ka bërë (ose e bën) këtë, ndërkohë që 90% e tyre janë paguar për punën e tyre. Kjo është veçanërisht e rëndësishme, pasi kalimi nga shkolla në punë ose sipërmarrje përcaktohet në mënyrë thelbësore nga ekspozimi i studentëve ndaj punës.

FIGURA 14: PËRQINDJA E TË RINJVE QË KANË PUNUAR (OSE AKTUALISHT PUNOJNË) GJATË STUDIMEVE TË TYRE





FIGURA 15: PËRQINDJA E STUDENTËVE QË PUNOJNË QË JANË PAGUAR OSE PAGUHEN PËR PUNËN E TYRE



BURIMI: ANALIZA E IDRA

Pavarësisht nga niveli aktual i arsimit, ekziston një perceptim se arsimi i mesëm është i mjaftueshëm për të gjetur një punë të denjë, ndërkohë që vetëm ata që kanë përfunduar arsimin e lartë ose studimet pasuniversitare mendojnë se është niveli i nevojshëm për të gjetur një punë të denjë. Megjithatë, çdo kategori mund të ketë një perceptim të ndryshëm për një punë të denjë.


TABELA 2: PERCEPTIMI MBI NIVELIN E ARSIMIT/FORMIMIT TË NEVOJSHËM PËR TË GJETUR NJË PUNË TË MIRË KËTO DITË – SIPAS NIVELIT AKTUAL TË ARSIMIT

Niveli aktual i arsimit					
		Shkolla fillore	Shkollë e mesme ose profesionale	Arsimi i lartë ose pasuniversitar	Totali
Niveli i arsimit/formimit të nevojshëm për të gjetur një punë të mirë këto ditë	Shkolla fillore	36%	23%	7%	18%
	Shkolla profesionale	5%	7%	1%	5%
	Shkolla e mesme	36%	38%	7%	35%
	Arsim i lartë	23%	28%	14%	35%
	Pasuniversitar	0%	4%	15%	8%

BURIMI: ANALIZA E IDRA

Rezultatet e studimit sugjerojnë se të rinjtë në qarkun e Shkodrës në fakt mendojnë se aftësitë e buta janë shumë më të rëndësishme për të gjetur një punë. Siç tregon **Figura 16**, të rinjtë mendojnë se aftësitë e komunikimit, njohuritë për botën e biznesit, zotërimi i gjuhëve, arsimimi i mirë i përgjithshëm dhe ambicia janë më të rëndësishmet për të gjetur një punë të mirë. Nga ana tjetër, kualifikimet shkencore ose teknike dhe aftësitë e TIK-ut nuk merren parasysh në masë të gjerë.

FIGURA 16: CILA NGA CILËSITË E MËPOSHTME MENDONI SE ËSHTË MË E DOBISHME PËR TË GJETUR NJË PUNË TË MIRË?




BURIMI: ANALIZA E IDRA

SHËNIM: PYETJE E SHUMËFISHTË ME DERI NË TRE PËRGJIGJE

Modelet e preferencës së të rinjve në qarkun e Shkodrës sugjerojnë bindshëm se kanë një dëshirë sipërmarrëse, pasi 68% e tyre zgjedhin të kenë biznesin e tyre si llojin më të preferuar të punës . Kjo ndiqet vetëm nga 16% që preferojnë në mënyrë ideale të punojnë për qeverinë ose sektorin publik.


FIGURA 17: NË MËNYRË IDEALE, CILIN NGA LLOJET E MËPOSHTME TË PUNËS DO TË PREFERONIT?



BURIMI: ANALIZA E IDRA

Figura 18 tregon rezultatet për aktivitetin aktual të të rinjve në qarkun e Shkodrës. 24% e kampionit janë të papunë, 35% janë aktualisht duke ndjekur arsim dhe/ose trajnime, 36% janë të punësuar dhe vetëm 6% janë të vetëpunësuar. Bazuar në këto të dhëna, ne do të analizojmë më tej secilën nga kategoritë gjatë seksioneve në vijim.

FIGURA 18: JAVËN E FUNDIT CILI KA QENË AKTIVITETI JUAJ KRYESOR?




BURIMI: ANALIZA E IDRA

Rinia në Arsim

Ky seksion ofron një analizë të situatës dhe aspiratave të të rinjve që aktualisht ndjekin arsimin, ose 35% e kampionit të përgjithshëm (N=69). Nisur nga planet e të rinjve në arsim, bie në sy aspirata për vetëpunësim, pasi 48% e tyre duan të fillojnë aktivitetin e tyre të biznesit. Në vijim, 26% nuk janë të sigurt për planet e tyre, 16% do të kërkojnë një punë dhe 10% do të vazhdojnë menjëherë shkollimin e tyre. **Shtojca 1** paraqet dallimet ndërmjet të rinjve që ndjekin arsimin e mesëm dhe atyre që ndjekin atë të lartë. Ndërsa të rinjtë në arsimin e lartë janë më të prirur për të filluar aktivitetin e tyre të biznesit, për të kërkuar një punë, apo edhe për të vazhduar shkollimin e tyre, të rinjtë në arsimin e mesëm janë më pak të sigurt për planet e tyre (36% nuk e dinë).


FIGURA 19: ÇFARË PLANIFIKONI TË BËNI PAS PËRFUNDIMIT TË PROGRAMIT AKTUAL TË ARSIMIT/FORMIMIT?



BURIMI: ANALIZA E IDRA

Mënyra për të gjetur një punë paraqet një gjetje mjaft surprizuese, por shumë të rëndësishme. Shumica dërrmuese (74%) e të rinjve në arsim synojnë të kërkojnë një punë duke kërkuar ndihmë nga miqtë, të afërmit ose kolegët. Kjo dëshmon se kanale të tjera dhe disi më formale janë praktikisht jashtë fokusit. Kanalet e përfshira janë teorikisht të gjitha llojet e ndërmjetësimit ndërmjet ofertës dhe kërkesës për punë. Ndërmjetësuesit e tregut të punës luajnë një rol të rëndësishëm në ndërtimin e rrjeteve dhe reduktimin e kostove të transaksionit, në ndikimin dhe minimizimin e mospërputhjeve si nga aspekti i punëkërkuësve ashtu edhe nga punëdhënësit, si edhe në inkurajimin e individëve të paangazhuar për tu përfshirë në tregun e punës. Duke mos qenë në fokus të të rinjve, mungesa e kanaleve formale dëshmon për një lidhje shumë të brishtë midis ofertës dhe kërkesës për punë në këtë rajon.


FIGURA 20: SI KENI NDËRMEND TË KËRKONI NJË PUNË?



BURIMI: ANALIZA E IDRA

Më tej, të rinjve në arsim iu kërkua të vlerësonin gjasat për punësim në lidhje me aftësitë e tyre në sipërmarrje. Rreth 57% e tyre mendojnë se **kurrikulat** universitare i përgatitin në masë të madhe për të qenë sipërmarrës, ndërsa 34% kanë disa dyshime për këtë (disi të përgatitur). Ky rezultat është disi i diskutueshëm, duke marrë parasysh kurrikulat tepër teorike dhe të vjetra në Shqipëri. Rreth 60% e të rinjve mendojnë se më vonë mund të kanalizojnë në një masë të madhe aftësitë e tyre **teknike** për të drejtuar biznesin e tyre, ndërsa 31% kanë disa dyshime. Më tej, rreth 69% e të rinjve mendojnë se më vonë mund të kanalizojnë në një masë të madhe aftësitë e tyre të buta për të drejtuar biznesin e tyre, ndërsa 23% kanë disa dyshime. Rezultatet sugjerojnë nivele të larta besimi në kapacitetin e punësimit të aftësive të tyre në sipërmarrje.

FIGURA 21: PERCEPTIMET E TË RINJVE NË ARSIM MBI KAPACITETIN E PUNËSIMIT TË AFTËSIVE TË TYRE NË SIPËRMARRJE



BURIMI: ANALIZA E IDRA

SHËNIM: VETËM TË RINJTË QË JANË AKTUALISHT NË ARSIMIN E LARTË (N=35).

Rinia e papunë

Ky seksion ofron një analizë të situatës dhe aspiratave të të rinjve që janë aktualisht të papunë, ose 24% e kampionit të përgjithshëm (N=48). Rezultatet tregojnë se 25% e të rinjve janë në kërkim aktiv për punë, ndërsa 8% po përpiqen të krijojnë biznesin e tyre. Nga ana tjetër, 67% nuk po bëjnë asnjërën nga këto.

FIGURA 22: ÇFARË E PËRSHKRUAN MË MIRË POZICIONIN TUAJ?






FIGURA 23: GJATË KATËR JAVËVE TË FUNDIT, A KENI NDËRMARRË NDOJË HAP PËR TË GJETUR PUNË OSE PËR TË KRIJUAR BIZNESIN TUAJ?



BURIMI: ANALIZA E IDRA


Nga ata që ndërmorën iniciativa për të kërkuar punë, mbizotëron (përsëri) kërkimi i ndihmës nga miqtë dhe të afërmit, duke përforcuar faktin e një lidhjeje të brishtë ndërmjet ofertës dhe kërkesës për punë në rajon. Nga ana tjetër, ata që nuk kanë ndërmarrë hapa për të gjetur punë, e kanë bërë këtë kryesisht për shkak të përgjegjësive personale/familjare ose do të fillojnë më vonë të kërkojnë punë.

FIGURA 24: ÇFARË HAPASH KENI NDËRMARRË PËR TË KËRKUAR PUNË GJATË KATËR JAVËVE TË FUNDIT?



SHËNIM: PËRGJIGJE TË SHUMËFISHTA DERI NË TRE ZGJEDHJE; VETËM ATA QË KANË NDËRMARRË NDOJË HAP PËR TË GJETUR PUNË

FIGURA 25: CILA ËSHTË ARSYEJA KRYESORE QË NUK KENI KËRKUAR PUNË GJATË KATËR JAVËVE TË FUNDIT?




SHËNIM: VETËM ATA QË NUK KANË NDËRMARRË ASNJË HAP PËR TË GJETUR PUNË

BURIMI: ANALIZA E IDRA

Duke marrë parasysh pengesat kryesore në gjetjen e një pune të mirë, të anketuarit zgjedhin pagat e ulëta në vendet e disponueshme të punës si arsye mbizotëruese (25%), të ndjekura nga pozicionet e pamjaftueshme të punës (19%) nga ana e kërkesës. Ndërsa nga ana e ofertës nuk spikasin përvojat e punës (17%) dhe arsimi i përgjithshëm i papërshtatshëm (15%) si arsye kryesore. Megjithatë, pengesat e perceptuara në anën e kërkesës së tregut të punës janë më të dukshme se pengesat në anën e ofertës.

FIGURA 26: CILA KA QENË PENGESA KRYESORE NË GJETJEN E NJË PUNE TË MIRË?




BURIMI: ANALIZA E IDRA

Të rinjtë e punësuar

Ky seksion ofron një analizë të situatës dhe aspiratave të të rinjve që janë aktualisht të punësuar, ose 36% e kampionit të përgjithshëm (N=72). Ajo që bie në sy është konfirmimi i informalitetit në sektorin e punësimit. Vetëm 49% e të rinjve kanë kontratë formale, ndërsa 51% nuk kanë një të tillë – kanë kontratë verbale në mirëbesim ose nuk kanë fare. Të punësuarit e ekonomisë informale shpesh përballen me një gamë më të madhe rreziqesh, të cilat reflektojnë në masë të madhe kushtet e tyre të punës dhe të jetesës. Puna në ekonominë informale shpesh karakterizohet nga kushte të këqija pune, nivele të ulëta të aftësive dhe produktivitetit, të ardhura të ulëta ose të parregullta, orë të gjata pune dhe mungesë aksesit në informacion, tregje, financa, trajnim dhe teknologji. Kështu, nivelet e larta të informalitetit paraqesin deformime të mëdha në tregun e punës.

Për më tepër, nivelet e larta të informalitetit kanë një ndikim të madh në politikat e tregut të punës. Ndërkohë që synohet një ndërhyrje me synim punësimin, përfitimet nga informaliteti pengojnë fuqinë punëtore të përfitojë prej tyre. Duke marrë parasysh politikat që synojnë vetëpunësimin, konkurrenca me informalitetin dekurajon dhe deformon nismat e ndërmarra në këtë mjedis.

FIGURA 27: SITUATA E KONTRATËS SË PUNËS




- Kam një kontratë afatgjatë me shkrim (12 muaj ose më shumë) ose me afat të papërcak...
- Kam një kontratë me shkrim me kohëzgjatje të kufizuar nën 12 muaj
- Kam një kontratë afatgjatë verbale (12 muaj ose më shumë) ose me afat të papërcaktua...
- Kam një kontratë verbale me kohëzgjatje të papërcaktuar nën 12 muaj
- Nuk kam kontratë

BURIMI: ANALIZA E IDRA

Duke marrë parasysh dallimet ndërmjet grupeve, informaliteti është fenomen më i përhapur në zonat rurale, pasi vetëm 44% e të rinjve kanë një kontratë formale, 11 persona më pak se në zonat urbane. Më tej, informaliteti është shumë më i përhapur tek të rinjtë meshkuj sesa femra, pasi vetëm 38% e të rinjve meshkuj kanë një kontratë formale, ose 29 persona më pak se femra.


FIGURA 28: PËRQINDJA E TË RINJVE QË KANË NJË KONTRATË PUNE FORMALE – SIPAS ZONAVE URBANE DHE GJINISË



BURIMI: ANALIZA E IDRA

Rreth 82% e të rinjve të punësuar janë të kënaqur me punën e tyre aktuale – 44% e të cilëve janë shumë të kënaqur dhe 38% janë disi të kënaqur. Duke marrë parasysh të punësuarit që kanë kontratë dhe ata që nuk kanë, dallimet janë relativisht të vogla. Nga të punësuarit që nuk kanë një kontratë 78% janë të kënaqur, ndërsa nga punëtorët që kanë kontratë 86% janë të kënaqur. Megjithatë, ka dallime të konsiderueshme kur merren parasysh nuancat e përmbushjes së kënaqësisë pasi nga të punësuarit pa kontratë vetëm 32% janë shumë të kënaqur, ndërsa nga ana tjetër 57% e punëtorëve me kontratë janë shumë të kënaqur.


FIGURA 29: NIVELI I KËNAQËSISË ME PUNËN AKTUALE – I NDARË SIPAS FORMALITETIT TË KONTRATËS



BURIMI: ANALIZA E IDRA

Të dyja arsyet për të qenë të kënaqur ose të pakënaqur me punën e tyre aktuale janë të lidhura me pagën. Në rastin e të rinjve që janë të kënaqur me punën e tyre, 37% deklarojnë si arsye pagën, ndërsa 22% deklarojnë kushte të mira pune dhe 17% sigurinë e punës. Nga ana tjetër, 46% e të rinjve të pakënaqur me punën e tyre deklarojnë si arsye thelbësore pagën e ulët, ndërsa 23% deklarojnë kushtet e këqija të punës dhe 15% mungesën e perspektivës për karrierë.


FIGURA 30: ARSYET PËR TË QENË TË KËNAQUR ME PUNËN AKTUALE



SHËNIM: VETËM ATA QË DEKLARUAN TË JENË TË KËNAQUR ME PUNËN AKTUALE.

BURIMI: ANALIZA E IDRA


FIGURA 31: ARSYET PËR TË QENË TË PAKËNAQUR ME PUNËN AKTUALE



SHËNIM: VETËM ATA QË DEKLARUAN SE JANË TË PAKËNAQUR ME PUNËN AKTUALE.

Rreth 88% e të rinjve të punësuar nuk kanë ndërmend të ndryshojnë vendin e punës në të ardhmen e afërt, gjë që sugjeron një nivel të lartë qëndrueshmërie në punë. Nga ana tjetër, vetëm 10% kanë synim të kalojnë në një punë tjetër, ndërsa vetëm 3% kanë bërë plane për ta bërë këtë. Ndarja e mëtëjshme tregon se ekziston një lidhje midis nivelit të kënaqësisë dhe qëllimit për të ndryshuar vendin e punës, pasi ata që janë më pak të kënaqur janë më të gatshëm për të ndryshuar punë (shih **Shtojca 3**).


FIGURA 32: SYNIMI PËR TË NDRYSHUAR VENDIN E PUNËS



BURIMI: ANALIZA E IDRA

Nga ana tjetër, të rinjtë e punësuar kanë besim në stabilitetin e punës së tyre. Në mënyrë specifike, 81% mendojnë se janë në gjendje të mbajnë punën e tyre në 12 muajt e ardhshëm, ndërsa 11% mendojnë se është e mundshme, por jo e sigurt. Vetëm 1% mendojnë se nuk ka gjasa të mbajnë punën e tyre në 12 muajt e ardhshëm. Këto rezultate mbështesin stabilitetin e vendeve të punës në rajon.

FIGURA 33: DUKE MENDUAR PËR 12 MUAJT E ARDHSHËM, SA MUND TË BESONI SE DO TË JENI NË GJENDJE TË MBANI PUNËN TUAJ KRYESORE NËSE DËSHIRONI?



BURIMI: ANALIZA E IDRA

Sipërmarrësit e Rinj dhe Sipërmarrësit Aspirues

Ne i bazojmë gjetjet për të rinjtë e vetëpunësuar në komponentin kërkimor cilësor të metodologjisë sonë. Janë realizuar dy fokus grupe me të rinj të cilët janë të vetëpunësuar dhe konsiderohen të vetëpunësuar. FG i parë përfshin të rinjtë e vetëpunësuar ndërsa i dyti përfshin të rinjtë që aspirojnë sipërmarrjen (shih **Shtojca 5** dhe **Shtojca 6**).

Sipërmarrësit e rinj

Sipërmarrësit e rinj kanë iniciativën dhe përpjekjet e dedikuara për të eksploruar mundësi të reja biznesi, për të shpikur dhe komercializuar mallra të reja dhe për të ofruar shërbime dhe metoda novatore të prodhimit. Sipërmarrësit marrin përsipër rrezikun e kombinimit të njohurive, kapitalit dhe burimeve për të krijuar një sipërmarrje që ka gjasa pozitive të kthejë investimin me fitim. Megjithatë, sipërmarrja nuk është fushë me lule, por ia vlen nëse përqafohet në mënyrën e duhur rrugëtimi i fillimit të një biznesi.

Për më tepër, rruga drejt sipërmarrjes është e mbushur me shumë sfida si plane që nuk funksionojnë, fonde që nuk do të kthehen menjëherë dhe klientë që kanë nevojë për kohë për t'u materializuar. Në këtë drejtim, mund të jetë e vështirë për të themeluar një biznes. Megjithatë, përkundër këtyre vështirësive, sipas pjesëmarrësve, një numër i madh i sipërmarrësve nisin këtë rrugëtim për të materializuar vizionin e tyre. Nismat e kanë origjinën nga *start-up*-et, me synim sipërmarrjet për të krijuar ose dizajnuar një produkt ose shërbim. **Përveç kësaj, përpara se të drejtojnë biznesin e tyre, të gjithë pjesëmarrësit e grupit kanë përvojë pune dhe janë të punësuar me pagë dhe e shohin këtë si rrugën e vetme drejt sipërmarrjes së suksesshme.** Pa dyshim, ky grup ka shumë gjasa që të ketë qenë i angazhuar me kohë të plotë përpara se të fillonte sipërmarrjen.



Përvoja në vendin e punës plotëson studimet akademike duke ofruar një mënyrë tjetër të të mësuarit jashtë shkollimit, duke ofruar njohuri thelbësore, përvoja dhe cilësi personale që kërkojnë kompanitë.

Architecture Studio, Shkodër, Albania.

Për më tepër, natyra e biznesit për ato sipërmarrje të pjesëmarrësve varion nga sektori i TIK, agjencia turistike, agroturizmi. Për më tepër, shumica e sipërmarrjeve janë veprimtari biznesi me zotërim familjar në të cilat përfshihen dy ose maksimumi katër anëtarë të familjes, dhe pjesa më e madhe e pronësisë ose kontrollit është brenda një familjeje. Shumica e pjesëmarrësve e konsideronin biznesin si burimin e tyre kryesor të të ardhurave – ata që nuk mendonin se biznesi i tyre ishte burimi kryesor i të ardhurave, punonin në një vend pune tjetër. **Në fushën e TIK-ut dhe arkitekturës, pjesëmarrësit e profesionistëve në këto fusha, të cilët janë të punësuar me kohë të plotë diku tjetër, ofrojnë shërbime si ekspertë në sipërmarrje– në mënyrë që të ruajnë stabilitetin financiar dhe për të zvogëluar rrezikun, ata fillojnë të përpiqen të krijojnë sipërmarrjen e tyre ndërsa janë të punësuar diku tjetër.** Përveç kategorisë së fundit, të gjithë të tjerët në grup janë të përkushtuar ndaj veprimtarisë së biznesit të tyre të krijuar dhe industria mbetet burimi kryesor i të ardhurave.



Unë punoja në një agjenci udhëtimesh, por për shkak të pagave të ulëta dhe të punës për orët shtesë pa pagesë, vendosa të përdor kursimet e mia për të hapur vetë një agjenci turistike. Unë tashmë ofroj shërbime për më shumë se gjashtë vjet në treg, ku shumica e klientëve të mi i marrin shërbimet online.

Agjencia Turistike, Shkodër, Shqipëri.

Pjesëmarrësit pohojnë se është thelbësore që sipërmarrësit aspirantë të kenë një pamje të qartë të produktit dhe shërbimit që do të ofrojnë në kontekstin rajonal. Dhe është pikërisht konteksti që mund të ndryshojë rrugën e biznesit – pasi të gjithë pjesëmarrësit pohojnë se ideja e tyre fillestare për biznesin e tyre ka ndryshuar gjatë rrugës.

Kam punuar prej vitesh në një vend të huaj, në restorante të ndryshme, ndaj kisha ide të qarta për biznesin tim që ofronte kuzhinë tradicionale. Me gati 15 vite në treg, biznesi ka tashmë 15 punonjës me kohë të plotë dhe ndërvepron me 200 fermerë në qarkun e Shkodrës nga të cilët merr produkte ushqimore si mish, produkte qumështi, etj.

Bar Restaurant, Shkodër, Shqipëri.

Megjithatë, asnjë nga pjesëmarrësit nuk bëri kërkime të hershme të tregut përpara se të hapte aktivitetin e biznesit. Por nga ana tjetër, disa prej tyre kishin dijeni për nevojat e tregut, tregues që kishin marrë nga kontaktet e tyre të përditshme në punë.

Unë jam një ofrues i shërbimeve IT, punoj në një institucion publik, por gjithashtu ofroj shërbime si i pavarur në fundjavë ose në kohën time të lirë. Vendosa ta hap këtë biznes sepse vura re se tregu kërkon shërbime IT dhe programim. Isha i qartë për hapat që duhej të ndiqja dhe klientët që duhej t'u shërbeja në këtë proces, ndaj procesi nuk ishte stresues.

Programues IT Pjesëmarrësi 1,
Shkodër, Shqipëri.

Jam analist i biznesit të të dhënave IT me përvojë 13 vjeçare në institucione publike. Së bashku me një koleg, ne ofrojmë shërbime si biznes privat për më shumë se një vit. Shërbimet e IT-së janë të kërkuara në treg, ndaj hapja e biznesit erdhi pasi kemi vlerësuar nevojën për ofrimin e shërbimeve të tilla.

Programues IT Pjesëmarrësi 1,
Shkodër, Shqipëri.

Për më tepër, kur bëhet fjalë për skemat e financimit, metodat e financimit janë të ndryshme: duke filluar nga përdorimi i kursimeve të tyre dhe ndihma e prindërve, disa ishin edhe përfitues të disa skemave të granteve. Në çdo rast, ndërtimi i një biznesi kërkon fonde dhe duhet të hartohet një plan biznesi për të përfituar këto fonde. Një opsion është të merret një kredi nga një institucion financiar, huadhënie për të mbuluar pjesën më të madhe të shpenzimeve ose të bashkëpunohet me një investitor sipërmarrjeje ose investitor mbështetës, në varësi të llojit të veprimtarisë së biznesit. Për më tepër, një opsion tjetër është financimi kolektiv(crowdfunding) ose **kërkimi i ndihmës nga miqtë dhe anëtarët e familjes** . Si një plotësues i këtyre qasjeve, ose ndoshta si modeli ekskluziv i financimit, plani mund të konsiderojë gjithashtu në shfrytëzimin e kursimeve dhe investimin e kapitalit, kryesisht të pjesëmarrësve të përmendur që kanë përdorur kursimet e tyre në fillimin e *start-up*-it, prandaj, janë më pak të shqetësuar për shpenzimet fillestare të financimit.



Biznesi është ngritur me kursimet e mia, pasi kam punuar diku tjetër përpara se të hapja agjencinë time të udhëtimeve, ku tashmë kam tre punonjës. Përveç kësaj, këtë muaj do të hap një agjenci të dyfishtë.

Agjencia Turistike, Shkodër, Shqipëri.



Ne ofrojmë punë artizanale me mëngë të gjata nga punimi i mëndafshit prej tre vitesh tashmë, pesë punonjës me kohë të plotë dhe pesë punonjës me kohë të pjesshme. Për blerjen e makinerive që kishin një vlerë të konsiderueshme, ne u shpallëm përfituesi i një granti të financuar nga BE-ja. Qëllimi është të zgjerohet aktiviteti tregtar i biznesit duke ekspozuar produktet dhe shërbimet në një audiencë më të gjerë. Përveç kësaj, rritja e bazës së klientëve do të ndihmojë në krijimin e më shumë klientëve dhe përmirësimin e shitjeve, duke çuar kështu në fitime më të larta. Më tej, ne ofrojmë produkte novatore: ku kemi mbjellë 500 fidanë. Në këtë fushë po trajnojmë edhe të rinj të 6 shkollave të mesme të Vaut të Dejës.

Industria Artizanale e
Mëndafshit, Shkodër, Shqipëri.



Jam përfituese e skemës së granteve për produktet BIO. Megjithatë, ka ende nevojë për financime shtesë pasi ka kosto të lartë prodhimi, kërkesa është e ulët, ka konkurrencë të lartë me produkte jo bio dhe është i nevojshëm krijimi i një tregu të përshtatshëm BIO.

Vreshtaria, Shkodër, Shqipëri.



Ne ofrojmë në treg bimë organike ku thahen fruta të tilla si molla, të cilat tregtohen vetëm në qarkun e Shkodrës. Një shoqatë italiane na ka financuar me grante. Mbështetja ka qenë e mirë dhe ka përmbushur kërkesat tona, dhe ne e kemi vlerësuar për fillimin e biznesit në një periudhë të shkurtër. Megjithatë, mbështetja nuk mjafton për një kohëzgjatje të konsiderueshme pasi synojmë konsolidimin.

Ferma Organike, Shkodër, Shqipëri.

Referuar gjetjeve të mënyrave të financimit, pavarësisht nga mundësitë financiare për të ngritur biznesin me fondet e tyre apo grantet e ofruara, të gjithë pjesëmarrësit ishin të motivuar të kenë biznesin e tyre në fushën e tyre dinamike. **Motivi kryesor ose primar për fillimin e një biznesi është të jesh vazhdimisht i pavarur.** Gjatë gjithë diskutimit, pjesëmarrësit përmendën se dëshira për të punuar në mënyrë të pavarur sipas gjykimit vetjak është shtysa e menjëhershme për të filluar një sipërmarrje. Zotëruesit e bizneseve u shprehën se janë shumë të përkushtuar për ndërtimin e këtyre bizneseve. Ata kurrë nuk e kanë menduar mbylljen e biznesit të tyre, edhe pse teknologjitë e ndryshme prodhojnë sfida, të cilat mund të mos i kishin parashikuar kur filluan biznesin. Gjithashtu, sipas aktivitetit të pjesëmarrësve, ata ishin në kërkim të një përvoje të re produktive dhe një mundësie unike.



Kantina jonë e verës ka 20 vjet që operon në sektorin e prodhimit. Ne kemi 2-3 punëtorë sezonalë në sezonin e punës në vreshta, ndërsa katër anëtarë të familjes janë të punësuar me kohë të plotë. E gjithë familja është e përfshirë në këtë biznes familjar; kjo ka ndikuar edhe në dëshirën time për ta konsoliduar më tej këtë biznes. Për më tepër, kemi planifikuar të ofrojmë verë për restorantet që emigrantët shqiptarë menaxhojnë jashtë vendit. Po ashtu synojmë edhe tregun në Kosovë. Përveç kësaj, kemi synuar të zgjerojmë biznesin me bujtina/shërbime hoteliere krahas prodhimit të verës.

Kantina e Verës Agroturizëm, Shkodër, Shqipëri.

Gjithashtu, u përmend se të gjithë ishin ndikuar nga çdo përvojë tjetër e mëparshme që kishin në vendimin për të nisur biznesin. Megjithatë, siç u përmend nga pjesëmarrësit, ndonjëherë burokracia dekurajon dëshirën për të menaxhuar biznesin, që përkthehet në më shumë lehtësira tatimore dhe staf më i mirë dhe i qëndrueshëm kur kemi të bëjmë me **start-up**. Në vazhdim të këtij diskutimi, një nga pjesëmarrësit përmendi se kontributet shëndetësore janë shumë të larta kur je i vetëpunësuar.

Gjatë gjithë diskutimit mbizotëruan ndjenjat dhe mendimet pozitive për të ardhmen e biznesit të tyre. Gjatë këtij diskutimi, pjesëmarrësit përmendën se kishin për synim të zgjeronin aktivitetin e tyre në treg duke treguar përkushtim maksimal ndaj biznesit. Ata njëzëri ranë dakord të fokusoheshin në progresin e biznesit të tyre, dhe askujt nuk i shkonte në mendje dhe as nuk dëshironte ta mbyllte biznesin apo ta zvogëlonte atë.

Një gjetje interesante e këtij fokus grupi ishin **investimet në partneritete, ndihma ndaj sipërmarrësve të rinj, përballja me ta, ofrimi i produkteve apo shërbimeve të reja në treg dhe synimi për t'u zgjeruar dhe për të rritur performancën.** Një nga pjesëmarrësit tha se biznesmenët në fushën e agroturizmit duhet të bëjnë përpjekje të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin. Më tej, ata duhet të kenë një plan të qartë biznesi për të gjithë ata që duan të nisin një partneritet.



Agropërpunuesit nuk kanë interes të blejnë produkte me TVSH 6% kur ua shesin konsumatorit me 20%. Për të mbështetur sipërmarrësit, duhet të aplikohen stimuj ekonomikë si maksimizimi i kursimeve tatimore dhe zhvillimi i burimeve të përhershme. Firma bashkëpunon me fermerët bujqësorë vendas për të marrë të korrat si lëndë e parë përbërësish. Ajo siguron rigjallërim financiar rajonal duke paraqitur marrëveshje të plota prodhim-blerje dhe duke marrë në mënyrë aktive produkte të ndryshme për të ruajtur rotacionin rendin e rotacionit. Përveç kësaj, bizneset mund të rrisin numrin e punonjësve me kohë të plotë për të punuar të motivuar për një periudhë të gjatë, duke kontribuar më tej në punësimin rajonal.

Bar Restaurant, Shkodër, Albania.



Unë kam synime afatgjata: të zhvilloj më tej biznesin në qarkun e Shkodrës dhe më pas synoj tregun botëror pasi tashmë kam përvojë me projektet në tregun gjerman.

Studio e Arkitekturës, Shkodër, Shqipëri.

Sipërmarrësit aspirues

Më tej, analiza identifikon dhe kupton nxitësit dhe pengesat që ndikojnë tek sipërmarrësit e rinj që mendojnë të krijojnë një biznes ose që kanë plane konkrete për të filluar një biznes për të zhvilluar një rekord të saktë segmentimi në mënyrë që të zhvillojnë performancën e bashkëpunimit. Qëllimi ishte të kuptoheshin nevojat e sipërmarrësve të rinj dhe të zgjerohej perceptimi i partnerëve dhe mbështetësve të sipërmarrjes rinore, udhëzuesve të ndihmës dhe modeleve të suksesshme në këtë rajon.

Gjithashtu, duke iu referuar pjesëmarrësve, disa prej tyre janë të punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme. Vetëm gjysma e atyre që bashkëpunojnë në grup ishin studentë ose të sapodiplomuar dhe nuk kishin ndonjë përvojë pune. **Ideja bazë me të cilën u pajtua i gjithë grupi është marrja në konsideratë e sipërmarrjes për shkak të mungesës së mundësive të punësimit dhe pagave të ulëta në vendet e punës ekzistuese**. Pra, ata që studiojnë nuk shohin shumë mundësi punësimi pas diplomimit dhe e shohin sipërmarrjen si një plan konkret për një të ardhme të sigurt. Dhe ata që punojnë mendojnë se ka mundësi më të mira të ardhurash në sipërmarrje sesa në punësimin aktual.




Aktualisht jam duke studiuar arkitekturë; pas diplomimit, synoj që së shpejti të gjej një punë në këtë industri dhe më pas, në të ardhmen, të hap studion time të arkitekturës.

Student i Arkitekturës, Shkodër, Shqipëri.



Unë jam duke studiuar në degën e Biokimisë. Duke qenë se është e vështirë të gjeshe një punë në Shkodër, kam ndërmend të hap një laborator mjekësor pas diplomimit.

Student i Biologji-Kimisë, Shkodër, Shqipëri.



Kam studiuar për infermieri dhe kam dy vjet e gjysmë që kam mbaruar studimet, por nuk mund të punësohem në profesion. Kam ndërmend të hap një dyqan fizik veshjesh gjatë verës kështu që do të jem i angazhuar në punë.

Organic Farm, Shkodër, Albania.

Motivimi për të filluar një biznes është kryesisht financiar. Ata mendojnë se të pasurit e një biznesi do t'u sigurojë atyre më shumë të ardhura se çdo punë tjetër. Por për të arritur atje, ekziston një rrezik thelbësor. Rreziku i parë është kostoja e hapjes së biznesit, e cila për shkak të mungesës së fondeve në dispozicion është një barrë e rëndë. Më tej ekziston shqetësimi për të pasur të ardhura të rregullta, veçanërisht në hapat e parë të biznesit.



Një nga avantazhet kryesore të një start-up-i është pavarësia financiare: Unë mund të realizoj ëndrrën e lirisë ekonomike, të ardhurave më të larta dhe shfrytëzimit të mundësive që kërkon tregu. Për më tepër, jam duke u përpjekur të hap një agjenci udhëtimesh, madje që tani kam filluar të organizoj ekipin. Gjithashtu, duke marrë parasysh vendimin për t'u rikthyer në vetëpunësim qëllimi është që të kryej detyrat në planin tim dhe të operoj në kushte origjinale më të mira dhe fleksibël.

**Punësuar si ekonomist,
Shkodër, Shqipëri.**



Jam punëtore me kohë të pjesshme dhe ndërkohë punoj edhe në punë artizanale mbi dy vite pasi kam kryer një kurs profesional dhe kryesisht klientët janë individë të njohur. Pengesa më e madhe në fillimin e një biznesi janë kostot e hapjes dhe shpenzimet që duhen derisa të ketë të ardhura të qëndrueshme. Krijimi i një sipërmarrjeje nga e para është më i rrezikshëm sesa blerja e një biznesi aktual që gjeneron një fluks parash dhe kthen një fitim.

**Punonjës me kohë të pjesshme në fabrikën e
veshjeve, Shkodër, Shqipëri.**

Përveç kësaj, **pjesëmarrësit e konsiderojnë veten si të papërgatitur për fillimin dhe drejtimin e një biznesi** . Ata mendojnë se drejtimi i një biznesi kërkon aftësi dhe njohuri shumëdimensionale në lidhje me zinxhirin e furnizimit, menaxhimin financiar, shtrirjen e tregut, etj. Ata mendojnë se do të ndiheshin shumë komod dhe të motivuar nëse do të kishin mbështetje këshilluese për ngritjen dhe drejtimin e një biznesi. **Më tej, ata absolutisht ranë dakord që do të planifikonin hapjen e një biznesi nëse ishin në dijeni të skemave të financimit dhe granteve.** Prandaj, shqetësimet më të mëdha të pjesëmarrësve, siç deklaruan ata, ishin të lidhura me mungesën e burimeve financiare për fillimin e biznesit. Gjatë gjithë analizës së përgjigjeve mbizotëruan mendimet konkrete për të ardhmen e tyre të biznesit. Në këtë diskutim, pjesëmarrësit përmendën synimin për t'iu përkushtuar biznesit, jo duke e konsideruar atë thjesht si një iniciativë eksperimentale.



Unë kam studiuar psikologji dhe aktualisht punoj në një OJQ. Kam ndërmend të hap një biznes që ofron shërbime katering pasi kam vënë re se pas pandemisë kërkohet gjithnjë e më shumë shërbimi i dërgesave në destinacion. Nuk e kam ndërmarrë këtë hap deri më tani për mungesë fondesh. Me biznesin që kam ndërmend të hap, do të jem i përfshirë me kohë të plotë dhe do të kem afërsisht 7-8 punonjës. Unë jam i interesuar për skemat e granteve mbështetëse për të arritur qëllimin tim.

Punësuar në një OJQ,
Shkodër, Shqipëri.




Aktualisht kam dy vite që punoj në profesionin si arkitekt, por kam në plan të hap studion time në të ardhmen, një plan afatmesëm realist (pas tre vitesh). Jam shumë i motivuar për këtë, ndaj pjesën më të madhe të kohës ia kushtoj përvetësimit të profesionit.

I punësuar si arkitekt, Shkodër, Shqipëri.

Mjedisi sipërmarrës

Duke marrë parasysh të gjithë të rinjtë e përfshirë në anketim, rreth 59% e tyre mendojnë të bëhen sipërmarrës. Synimi sipërmarrës i paraprin veprimin dhe drejton vëmendjen drejt qëllimit të krijimit të një biznesi të ri, duke siguruar kështu një bazë të rëndësishme për mjedisin sipërmarrës në rajon.

FIGURA 34: A KENI MENDUAR NDOJËHERË TË BËHENI NJË SIPËRMARRËS?




BURIMI: ANALIZA E IDRA


Ndarja e mëtejshme ofron disa nuanca interesante. Synimet sipërmarrëse janë shumë më të dukshme tek të rinjtë që banojnë në zonat urbane, pasi 67% e tyre konsiderojnë të bëhen sipërmarrës krahasuar me 53% në zonat rurale. Dallimet gjinore janë të vogla, me 62% të të rinjve meshkuj që mendojnë të bëhen sipërmarrës kundrejt 57% të rinjve femra.

Dallimi më i dukshëm mund të vërehet kur ndahet sipas grupmoshës. Rreth 76% e të rinjve të moshës 18-21 vjeç mendojnë të bëhen sipërmarrës, të ndjekur nga 54% e të rinjve të moshës 22-26 vjeç dhe 45% e të rinjve të grupmoshës 27-30 vjeç. Dallimet e paraqitura tregojnë një ambicie më të lartë në moshat më të reja. Duke marrë parasysh dallimet sipas arsimit, vërehet një kalim nga të rinjtë me arsim fillor në ata të arsimit të mesëm dhe të lartë, por dallimet midis të rinjve me arsim të mesëm dhe të lartë janë të papërfillshme.


FIGURA 35: PËRQINDJA E TË RINJVE QË MENDOJNË TË BËHEN SIPËRMARRËS – SIPAS ZONAVE URBANE, GJINISË, GRUPMOSHËS DHE ARSIMIT




MOSHA 18 - 21 VJEÇ




MOSHA 22 - 26 VJEÇ




MOSHA 27 - 30 VJEÇ




ARSIMI FILLOR



ARSIMI I MESËM




ARSIMI I LARTË



BURIMI: ANALIZA E IDRA

Nga të rinjtë që kishin synime sipërmarrëse, 42% mendojnë se këshillat dhe udhëzimet do t'i ndihmonin ata të arrinin konsideratat e tyre sipërmarrëse, e ndjekur nga 39% që mendojnë se ndihma për kërkimin e fondeve do t'i lehtësonte. Prandaj, këto të dyja shquhen si ndërhyrje të mundshme për përmirësimin e mjedisit sipërmarrës, duke e kanalizuar synimin sipërmarrës në veprim konkret. Nga ana tjetër, të rinjtë që nuk kanë synime sipërmarrëse, nuk e konsiderojnë si opsion për arsye të ndryshme. Kryesisht, 28% mendojnë se nuk kanë aftësitë e duhura, pasuar nga 26% që mendojnë se nuk kanë burimet financiare. Kjo nxjerr në pah aksesin në burime financiare si një ndërhyrje madhore për promovimin e sipërmarrjes në rajon.


FIGURA 36: ÇFARË MENDONI SE DO T'JU NDIHMONTE TË ARRINI SYNIMIN TUAJ SIPËRMARRËS?



SHËNIM: VETËM ATA QË E KONSIDEROJNË SIPËRMARRJEN

BURIMI: ANALIZA E IDRA

FIGURA 37: PSE NUK MENDONI TË BËHENI NJË SIPËRMARRËS?




SHËNIM: VETËM ATA QË NUK E KONSIDEROJNË SIPËRMARRJEN

Së fundi, ne testojmë perceptimin e të rinjve për mjedisin sipërmarrës në rajon bazuar në dimensionet shumëfishta. Një grup deklaratah u vunë në dispozicion, dhe të anketuarve iu kërkua t'i vlerësonin ato në një shkallë nga 0 deri në 10, ku 0 ishte plotësisht e rreme dhe 10 ishte plotësisht e vërtetë. Deklaratat përfshijnë dimensionet shumëfishta si p.sh.: infrastrukture; rregullatore; financiare; arsimore; si edhe mjedisin e politikave.

Rezultatet janë paraqitur në **Figura 38**, dhe një vijëzim është kryer te 5-a, që ndan pohimet e rreme dhe të vërteta. Deklaratat e paraqitura janë pozitive, prandaj sa më i lartë të jetë vlerësimi aq më i mirë është rezultati për mjedisin sipërmarrës. Në pamje të parë, nga 14 anketime të plotësuara, vetëm dy dimensione shënojnë më shumë se 5 – duke rënë në zonën e faktorit mbështetës, ndërsa shumica paraqesin kufizime. Pra, vetëm infrastruktura fizike dhe teknologjike[7] dëshmojnë të jenë relativisht mbështetëse për mjedisin sipërmarrës në rajon. Faktorë të tjerë, duke përfshirë stimujt rregullatorë, financiarë, arsimorë dhe politikë, paraqesin kufizime për mjedisin sipërmarrës të të rinjve në rajon. Dy më të ulëtat e vlerësuara janë politikat e pushtetit qendror dhe vendor në mbështetjen e sipërmarrjes. Më tej, nuk vërehen dallime të rëndësishme kur ndahen vlerësimet sipas grupeve (shih **Shtojca 4**).

Duhet theksuar se këto vlerësime bëhen nga të rinjtë dhe bazohen në perceptimet e tyre për situatën. Ndërsa perceptimi i tyre mund të bazohet në informacione asimetrike, nëse ka faktorë mbështetës për mjedisin sipërmarrës, këta faktorë duhet të shpërndahen siç duhet. Çdo iniciativë për të mbështetur (financiarisht ose jofinanciarisht) sipërmarrjen rinore në rajon duhet të shpërndahet siç duhet për të krijuar shtrirjen e duhur dhe për të ndikuar në synimin sipërmarrës.

FIGURA 38: VLERËSIMI I DIMENSIONEVE TË MJEDISIT SIPËRMARRËS



BURIMI: ANALIZA E IDRA

[7] Infrastruktura teknologjike si akses në internet, shpejtësia, telekomunikacioni etj. dhe infrastruktura fizike si rrugët etj.

Për të ofruar një analizë më gjithëpërfshirëse rreth mjedisit sipërmarrës në qarkun e Shkodrës, ne kemi realizuar 12 Intervista të Thelluara me përfaqësues të biznesit, OJF vendore, përfaqësues nga Zyra Rajonale e Punësimit, Dhoma e Tregtisë, Bashkia dhe Universiteti “Luigj Gurakuqi”. [8]

Për aktorët vendas, sipërmarrja rinore në qarkun e Shkodrës është ende e përgjumur. Kështu, aktiviteti sipërmarrës është i fokusuar më së shumti në aktivitetin e biznesit të mesëm dhe të vogël në fusha të tilla si turizmi, bujqësia dhe punët artizanale. Migrimi i brendshëm i të rinjve me aftësi të larta ka qenë një komponent kryesor në cenimin e mjedisit të sipërmarrjes në qarkun e Shkodrës, pasi të rinjtë e aftë kërkojnë mundësi në Tiranë ose jashtë saj. Më tej, ka mungesë të vetëdijes për mundësitë lokale të rinjtë që jetojnë atje, duke marrë parasysh edhe mungesën e të kuptuarit të mundësive për shkak të aftësive të ulëta të fituara përmes arsimit me cilësi të ulët ose mungesës së ekspozimit ndaj aktiviteteve sipërmarrëse.

Pavarësisht mundësive që ofron rajoni i Shkodrës, veçanërisht në turizëm dhe bujqësi, të **gjithë aktorët e intervistuar pohojnë se nuk ka ide biznesi të rëndësishme novatore (ose thjesht tradicionale) nga të rinjtë për t'u rritur në modele biznesi me rritje të shkallëzuar – ka vetëm *start-up*-e të neglizhuara me perspektivë të vogël rritjeje.** Për më tepër, ekziston një narrativë e përgjithshme se Shkodra është një nga rajonet pilot për *start-up*-et e TIK-ut, por kjo është shumë larg përmbushjes. Sektori i turizmit perceptohet si sektori kryesor që mund të akomodojë sipërmarrje të reja në afat të shkurtër, që konsiston në mundësi investimi duke përfshirë turizmin urban, turizmin malor, turizmin bregdetar dhe turizmin në liqene. Nga njëra anë, këto iniciativa nuk kërkojnë aftësi të larta, por më tepër aftësi praktike, dhe nga ana tjetër kanë shumë kosto fillestare të ulët të investimit (p.sh.. një guidë turistike). Iniciativat turistike mund të nxiten edhe nga aftësitë gjuhësore të të rinjve, kryesisht në gjuhën italiane dhe në anglisht, të cilat mund të jenë asete të rëndësishme në suksesin e sipërmarrjeve turistike.

Në përputhje me gjetjet e fokus grupeve, edhe aktorët e intervistuar pohojnë se dy drejtimet kryesore të mjedisit të sipërmarrjes rinore përfshijnë mjedisin e pafavorshëm të biznesit dhe aksesin në financa.

Biznesi më fitimprurës perceptohet si i lidhur me pushtetin politik ose i krijuar nga paratë e kanalizuar përmes aktivitetit të paligjshëm dhe historitë e suksesit të bizneseve me rritje të shkallëzuar ose të qëndrueshme të krijuara nga zero janë shumë të pakta. Për më tepër, ka pasur pak stimul, si p.sh. lehtësime tatimore ose fonde dhe programe të qeverisë për të filluar një biznes. Edhe të rinjtë që po mendojnë të hapin një biznes janë të pasigurt për sistemin dhe kriteret tatimore, ndërsa përfaqësuesit e intervistuar të bizneseve pohojnë se sistemi tatimor është vërtet i ndërlikuar dhe ndryshimet aktuale e bëjnë të vështirë fokusimin në çështjet e rëndësishme.

Qasja në financa është padyshim një sfidë e madhe për sipërmarrjen rinore në zonë, për sipërmarrjet në fazat e hershme. Megjithatë situata është më komplekse sesa mungesa e fondeve në dispozicion. Ka gjithnjë e më shumë mundësi për grante, të financuara nga donatorët ndërkombëtarë dhe në bashkëpunim me qeverinë, por shumat janë shumë të vogla për të sjellë një ndikim me peshë. Më tej, grantet nuk mbështeten me skemat e duhura të mentorimit dhe monitorimit, duke i lënë *start-up*-et ose të dështojnë vetë, ose ta konsiderojnë grantin si fitim dhe të mbyllin aktivitetin. Grantet e mëdha nuk janë të lehta për t'u përfituar. *Start-up*-et nuk ofrojnë perspektivat e rritjes që u parashikojnë grantet e mëdha për t'u përfituar. Disa nuk i përmbushin kushtet nga mungesa e dokumenteve të duhura, të tjerët nga mungesa e vizionit, por gjithçka e ka zanafillën në mungesën e aftësive për biznes.

Nga ana tjetër, mungesa e aktivitetit sipërmarrës lidhet edhe me situatën aktuale në tregun e punës. Idetë më të spikatura dhe të qëndrueshme të *start-up*-eve vijnë nga të rinj që kanë përvojë të mëparshme pune dhe kanë një farë shkalle njohurish për tregun dhe/ose kanë disa burime financiare për të ndërmarrë rrezikun. Por pagat e ulëta dhe papunësia nuk e bëjnë të realizueshme këtë. Dhe *start-up*-et mund të klasifikohen si të nxitura nga nevoja: Drejtori Rajonal i Agjencisë së Punësimit në Shkodër konfirmoi se në një event *start-up*-i përfshinte vetëm aplikantë të papunë.

Mungesa e modeleve rajonale është gjithashtu e dukshme. Historitë e pakta të suksesit perceptohen si të mjegullta, por gjithsesi ato konsistojnë në një rrugë të qartë për të rinjtë. Kjo veçanërisht vlen kur konsiderohen *start-up*-et e vogla të cilat janë shndërruar në sipërmarrje relativisht të mëdha.

[8] Shikoni Aneksin 7 për listën e detajuar të pjesëmarrësve.

KONKLUZIONE

Promovimi i punësimit produktiv dhe të denjë dhe i mundësive sipërmarrëse në rajon paraqet një detyrë komplekse, dhe shumë më tepër kur merret parasysh një grupmoshë specifike. Megjithatë, ky studim synon të ofrojë një analizë gjithëpërfshirëse që adreson nevojën për një kuptim më të thellë të sfidave dhe mundësive specifike rajonale për të rinjtë.

Rezultatet sasiore dëshmojnë se të rinjtë në qarkun e Shkodrës kanë një nivel arsimor relativisht të mirë, duke pasur parasysh edhe praninë e një universiteti në rajon. Rreth 41% e të rinjve të intervistuar kanë përfunduar (ose janë duke ndjekur) arsimin e lartë ose studimet pasuniversitare, ndërsa 48% kanë përfunduar (ose ndjekin) një shkollë të mesme ose profesionale dhe 11% kanë përfunduar vetëm shkollën fillore. Rezultatet tregojnë se 46% e të rinjve që kanë përfunduar arsimin e tyre kanë filluar menjëherë një punë, ndërsa shifra është 60% për të diplomuarit e arsimin të lartë. Kjo paraqet disa dëshmi që konfirmojnë lidhjen e dobët mes universiteteve dhe tregut të punës.

Rezultatet e studimit tregojnë se të rinjtë në qarkun e Shkodrës mendojnë se aftësitë e buta janë shumë më të rëndësishme për të gjetur një punë. Konkretisht, ata mendojnë se aftësitë e komunikimit, njohja e botës së biznesit, zotërimi i gjuhëve, arsimimi i mirë i përgjithshëm dhe ambicia janë më të rëndësishmet për të gjetur një punë të mirë. Nga ana tjetër, kualifikimet shkencore ose teknike dhe aftësitë e TIK-ut nuk merren parasysh në masë të gjerë. Megjithëse nuk ka asnjë dyshim për rëndësinë e aftësive të buta në tregun e punës, themelet janë aftësitë dhe njohuritë specifike të punës.

Për sa i përket situatës aktuale të të rinjve në qarkun e Shkodrës, të dhënat e studimit tregojnë se 35% ndjekin arsimin dhe/ose trajnimin, 36% janë të punësuar, 24% janë të papunë dhe 6% janë të vetëpunësuar.

Kur u pyetën për qasjen e tyre ndaj tregut të punës, shumica dërrmuese (74%) e të rinjve aktualisht në arsim synojnë të kërkojnë një punë duke kërkuar ndihmë nga miqtë, të afërmit ose kolegët. Më tej, nga të rinjtë e papunë që kërkojnë punë, kërkimi i ndihmës nga miqtë dhe të afërmit mbizotëronte sërish si qasja kryesore (58%). Kjo dëshmon se kanale të tjera dhe disi më formale janë praktikisht jashtë fokusit. Ndërmjetësuesit e tregut të punës luajnë një rol të rëndësishëm në ndërtimin e rrjeteve dhe reduktimin e kostove të transaksionit, në ndikimin dhe minimizimin e mospërputhjeve si nga aspekti i punëkërkuesve ashtu edhe nga punëdhënësit, si edhe në inkurajimin e individëve të paangazhuar për t'u përfshirë në tregun e punës. Duke mos qenë në fokusin e të rinjve, mungesa e kanaleve formale dëshmon për një lidhje shumë të brishtë midis ofertës dhe kërkesës për punë në këtë rajon.

Duke marrë parasysh pengesat kryesore në gjetjen e një pune të mirë, të anketuarit zgjedhin pagat e ulëta në vendet e disponueshme të punës si arsye mbizotëruese (25%), të ndjekura nga pozicionet e pamjaftueshme të punës (19%). Gjetjet cilësore konfirmojnë këtë situatë, e cila shërben edhe si një motivim për aspiratat për vetëpunësim – pasi nuk ka mjaft vende pune (ose punë të mira) në dispozicion, ose pagat në ato ekzistuese janë të ulëta, të rinjtë e mendojnë vetëpunësimin si një mundësi për të fituar jetesën. Prandaj, vetëpunësimi është kryesisht një aktivitet i drejtuar nga nevoja.

Deformimet në tregun e punës janë të dukshme kur vëzhgohet informaliteti i këtij sektori. Vetëm 49% e të rinjve kanë kontratë pune, ndërsa 51% nuk kanë një të tillë – kanë kontratë verbale në mirëbesim ose nuk kanë fare. Të punësuarit e ekonomisë informale shpesh përballen me një gamë më të madhe rreziqesh, të cilat reflektojnë në masë të madhe kushtet e tyre të punës dhe të jetesës. Puna në ekonominë informale shpesh karakterizohet nga kushte të këqija pune, nivele të ulëta të aftësive dhe produktivitetit, të ardhura të ulëta ose të parregullta, orë të gjata pune dhe mungesë aksesit në informacion, tregje, financa, trajnim dhe teknologji. Nga ana tjetër, ndërhyrjet në tregun e punës priren të jenë më pak efektive në këtë kontekst. Ndërkohë që synohet një ndërhyrje me synim punësimin, përfitimet nga informaliteti pengojnë fuqinë punëtore të përfitojë prej tyre. Duke marrë parasysh politikat që synojnë vetëpunësimin, konkurrenca me informalitetin dekurajon dhe deformon nismat e ndërmarra në këtë mjedis.

Të rinjtë e punësuar përgjithësisht duken të kënaqur me punën e tyre. Rreth 82% e të rinjve të punësuar janë të kënaqur me punën e tyre aktuale – 44% e të cilëve janë shumë të kënaqur dhe 38% janë disi të kënaqur. Megjithatë, ka dallime të papërfillshme në nivelin e pritshmërive të kënaqshme mes të rinjve që kanë një kontratë pune dhe atyre që punojnë pa kontratë, por ka dallime të konsiderueshme kur merren parasysh nuancat e përmbushjes së kënaqësisë, pasi nga të punësuarit pa kontratë vetëm 32% janë shumë të kënaqur, ndërsa nga ana tjetër 57% e punëtorëve me kontratë janë shumë të kënaqur. Arsyeja kryesore si për kënaqësinë ashtu edhe për pakënaqësinë duket të jetë paga, e cila konfirmon gjendjen bazë të tregut të punës. Megjithatë, të rinjtë e punësuar kanë një perceptim të qëndrueshëm për të ardhmen, pasi 88% nuk kanë ndërmend të ndryshojnë vendin e punës, ndërsa 81% mendojnë se mund ta mbajnë vendin e punës në 12 muajt e ardhshëm nëse dëshirojnë.

Sipërmarrja aspirohet shumë nga të rinjtë në rajon. Rreth 59% e tyre aspirojnë të jenë sipërmarrës. Megjithatë, ata kanë një perceptim negativ për mjedisin sipërmarrës në rajon. Për ta, mjedisi paraqet shumë kufizime, duke përfshirë iniciativat rregullatore, financiare, arsimore dhe politike. Ndërsa perceptimi i tyre mund të bazohet në informacione asimetrike, nëse ka faktorë mbështetës për mjedisin sipërmarrës, këta faktorë duhet të shpërndahen masivisht. Çdo iniciativë për të mbështetur (financiarisht ose jofinanciarisht) sipërmarrjen rinore në rajon duhet të shpërndahet siç duhet për të krijuar shtrirjen e duhur dhe për të ndikuar në synimin sipërmarrës.

Për aktorët vendas, sipërmarrja rinore në qarkun e Shkodrës është ende e përgjumur. Aktiviteti sipërmarrës është i fokusuar më së shumti në aktivitetin e biznesit të mesëm dhe të vogël në fusha të tilla si turizmi, bujqësia dhe punët artizanale. Migrimi i brendshëm i të rinjve me aftësi të larta ka qenë një komponent kryesor në cenimin e mjedisit të sipërmarrjes në qarkun e Shkodrës, pasi të rinjtë e aftë ose kërkojnë mundësi në Tiranë ose jashtë saj. Pavarësisht se ka disa mundësi, të gjithë aktorët lokalë deklarojnë se nuk ka ide biznesi të rëndësishme novatore (ose thjesht tradicionale) nga të rinjtë për t'u rritur në modele biznesi me rritje të shkallëzuar – ka vetëm *start-up*-e të neglizhuara me perspektivë të vogël rritjeje.

Në përputhje me gjetjet e fokus grupeve, edhe aktorët lokalë pohojnë se dy sfidat kryesore për mjedisin e sipërmarrjes rinore përfshijnë mjedisin e pafavorshëm të biznesit dhe qasjen në financa. Të rinjtë zakonisht janë të pasigurt për kuadrin tatimor dhe ligjor, ndërkohë që ky kuadër duket i ndërlikuar dhe dekurajues. Qasja në financa është padyshim një sfidë e madhe për sipërmarrjen rinore në zonë, për sipërmarrjet në fazat e hershme. Edhe pse ka gjithnjë e më shumë mundësi për grante, të financuara nga donatorë ndërkombëtarë dhe në bashkëpunim me qeverinë, shuma e granteve është shumë e vogël për të ofruar një ndikim të rëndësishëm dhe nuk shoqërohet siç duhet me skemat e duhura të mentorimit, duke i lënë *start-up-et* ose të dështojnë vetë, ose ta konsiderojnë grantin si fitim dhe ta mbyllin aktivitetin.

Bazuar në këtë analizë, ne ofrojmë disa rekomandime të përgjithshme për zhvillimin e sipërmarrjes dhe punësimit të të rinjve në qarkun e Shkodrës.

- Zhvillimi i sipërmarrjes rinore ka nevojë për një qasje më gjithëpërfshirëse, në vend të aktiviteteve specifike që trajtojnë aspekte të caktuara të problemit. Problemi me të cilin përballen sipërmarrja rinore në Shkodër është shumëdimensional. Ka disa probleme që duhen trajtuar nëpërmjet politikave të pushtetit vendor dhe qendror, universiteteve dhe shoqërisë civile. Si p.sh. krijimi i mundësive për financim pa një mjedis të qëndrueshëm të biznesit nuk do të çojë në sipërmarrje të suksesshme.
- Thjeshtimi, ose përndryshe sigurimi i një orientimi të vazhdueshëm për rregullat e biznesit. Të rinjtë përballen me pengesa të konsiderueshme brenda mjedisit të biznesit, të cilat i pengojnë ata të fillojnë dhe të rritin bizneset e tyre, duke përfshirë sistemin kompleks rregullator dhe koston e lartë të regjistrimit dhe mirëmbajtjes.
- Fokusimi në metodat që nxisin sipërmarrjen tek të rinjtë përmes zhvillimit të kompetencave. Ka disa pika tregu që mund të eksplorojnë nga të rinjtë si mundësi sipërmarrje. Megjithatë, ekziston nevoja për një kombinim të aftësive teknike dhe sociale për të identifikuar dhe shfrytëzuar mundësinë. Kurrikulat universitare duhet të përshtaten me nevojat e tregut dhe universitetet duhet të punojnë më ngushtësisht me sektorin privat për të përditësuar kurrikulat e tyre. Përveç kësaj, ka nevojë për forcimin e kapaciteteve të sistemeve të formimit profesional dhe të stazheve praktike për t'i pajisur të rinjtë me aftësitë për të ndjekur sipërmarrjen dhe vetëpunësimin.
- Dhënia e udhëzimeve jo vetëm për mënyrat se si mund të bëhesh sipërmarrës, por edhe për sektoret që kanë potencial për zhvillim që duhen ndjekur. Shumë të rinj janë të stërm bushur me informacion mbi hapat për t'u bërë sipërmarrës (si p.sh. hartimi i një plan biznesi, etj.), megjithatë ka shumë konfuzion se çfarë duhet të ndjekin. Ka sektorë të tillë si turizmi apo bujqësia, ose më dominante si TIK, që ofrojnë mundësi potenciale për vetëpunësim dhe sipërmarrje. Megjithatë, ekziston nevoja për një vlerësim dhe përpunim të detajuar të këtyre mundësive dhe gjithashtu një plan shpërndarjeje.
- Strukturat ekzistuese, si dhomat e tregtisë dhe rrjetet e tjera të biznesit duhet të jenë një pikë fokale në mbështetjen e zhvillimit të sipërmarrjes rinore. Rrjetet e biznesit mund të jenë të vlefshme për sipërmarrësit e rinj në mënyrë që të rriten dhe zgjerohen. Ata kanë përvojën, njohuritë dhe rrjetin operacional, të cilat mund të jenë thelbësore për sipërmarrësit në fazën e tyre fillestare dhe gjatë gjithë ciklit të tyre jetësor.
- Ofrimi i mundësive të konsiderueshme financimi së bashku me mentorim efektiv dhe monitorim rigoroz. Aksesimi në financa është një kufizim i madh për të rinjtë që duan të fillojnë ose të rritin një biznes. Edhe pse ka gjithnjë e më shumë mundësi për grante, shuma e tyre është shumë e vogël për të ofruar një ndikim të rëndësishëm dhe nuk shoqërohet siç duhet me skemat e duhura të mentorimit, duke i lënë start-up-et ose të dështojnë vetë, ose e konsiderojnë grantin si fitim dhe e mbyllin aktivitetin.

PJESA II: STUDIM NGA MALI I ZI

AUTORËT:

PAVLE PAVLOVIĆ
ANA MARJANOVIĆ

Tregu i punës është një hapësirë që ndikohet drejtpërdrejt nga zhvillimi i ekonomisë, zhvillimi i inovacioneve, teknologjive të reja, investimeve, zhvillimit ekonomik dhe social. Politika e punësimit si një nga shtytësit kryesorë të kësaj hapësire shërben si bazë për veprim brenda dhe ndërmjet vendeve. Rëndësia e një politike reflektohet në krijimin e një ekuilibri në tregun e punës nëpërmjet ndërhyrjeve të ndryshme, të cilat rregullojnë hendekun midis ofertës dhe kërkesës si dhe problematikat e grupeve të caktuara të popullsisë, të cilat janë në pozitë më të keqe në tregun e punës. Në dy vitet e fundit, sipërmarrja është njohur dhe mbështetur veçanërisht në nivel lokal dhe kombëtar si një nga synimet kryesore strategjike të vendeve përreth. Mungesa e vendeve të punës si dhe zhvillimi i pabarabartë rajonal kanë ndikuar që politikëbërësit ta shohin problemin përtej "dorës së padukshme" dhe t'i qasen atij strategjikisht në aspektin e masave. Megjithatë, rajoni i Ballkanit Perëndimor, i cili ndan kryesisht të njëjtën matricë kulturore, vuan nga problemet e tranzicionit të njohura si nepotizëm, korrupsion dhe koordinimi i dobët sistematik.

Në këtë klimë të përgjithshme pakënaqësie, problemi i papunësisë së të rinjve, përveçse një problem global, është një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballlet Mali i Zi në zhvillimin e tij social-ekonomik. Ky është një problem që, përveç qeverisë së Malit të Zi, njihet edhe nga organizatat ndërkombëtare si një nga segmentet kyçe të masave në të ardhmen — sipas raportit të UNDP-së të vitit 2017, shkalla e papunësisë tek të rinjtë është në një nivel të lartë ndërmjet 35-40%.

Në studim u përpoqëm të shqyrtojmë perspektivën e të rinjve në procesin e vetëpunësimit. Ne e kemi identifikuar këtë si një nga problemet e rëndësishme sepse të gjitha kërkimet e mëparshme sugjerojnë se çështja e vetëpunësimit dhe sipërmarrjes së të rinjve është e bllokuar mes aktivitetit dhe pasivitetit, mes nepotizmit dhe nevojës, dhe midis traditës dhe epokës digjitale. Studimi u realizua në kuadër të projektit "Work4Youth", i cili u iniciua si përgjigje ndaj përqindjes së lartë të papunësisë së të rinjve në rajonin ndërkufitar Mali i Zi - Shqipëri. Raporti studimor është përgatitur në bazë të analizës së situatës dhe nevojave në zonën e synuar, dhe është fokusuar në popullatën rinore në tri komuna në rajonin e projektit në Mal të Zi: Podgoricë, Tuzi dhe Tivar, me synimin e integritit dhe përfshirjes më të madhe të tregut të punës dhe njerëzve, shërbimeve dhe mallrave që e krijojnë atë.

PUNËSIMI DHE SIPËRMARRJA E TË RINJVE — përkufizimi dhe metodologjia e përdorur

Krizat ekonomike botërore mund të jenë dhe shërbejnë shpeshherë si iniciatorët më të mirë të politikave dhe drejtimeve të reja të zhvillimit në çështjet ekonomike. Kështu, për shembull, kriza ekonomike e viteve 2008-2009 shkaktoi një valë veprimi në qarqet politike me synim kapërcimin e pasojave të asaj krize në vorbullën e mangësive të perceptuara. Supozohet se kriza aktuale pandemike do të prodhojë efekte të ngjashme, sepse tashmë është vërejtur se disa profesione kanë qëndrueshmëri dhe rezistencë më të madhe në raport me pasojat e të bërit biznes gjatë një pandemie. Kushtet e reja dhe një mjedis i ri në biznesin sipërmarrës përfaqësojnë një bazë të mirë për aktivitete kërkimore që do të kapnin momentin dhe do të ofronin një bazë për punë më të mirë në këtë fushë.

Në literaturë ka shumë përkufizime të ndryshme të sipërmarrjes. Për shkak se 'sipërmarrja' është një term i përgjithshëm që përfshin shumë elementë, këto përkufizime shpesh mbivendosen dhe konfliktohen duke krijuar një konfuzion dhe mosmarrëveshje midis studiuesve dhe praktikuesve rreth asaj se çfarë është sipërmarrja (Parker, 2004). Në përgjithësi, përkufizimi i sipërmarrjes varet nga qasja disiplinore e studiuesit që e përcakton atë. Siç theksojnë Mascherini & Bisello (2015) për raportin e Eurofound që paraqesin heterogjenitet të përkufizimeve të ndryshme, përkufizimet e sipërmarrjes mund të grupohen në katër dimensionë të ndryshme: të përqendruara në detyrë, duke parë se çfarë bën një sipërmarrës; tipare dhe qëndrime psikologjike, se si mendon një sipërmarrës; të përqendruara në biznes, duke u fokusuar në karakteristikat e shoqërisë; ose si një koncept shumëdimensional që përfshin të gjitha sa më sipër. Në vijim të punës kryesore të Chigunta (2002) ne do të përkufizojmë sipërmarrjen e të rinjve si aplikim praktik i cilësive sipërmarrëse, të tilla si iniciativa, inovacioni, kreativiteti dhe ndërmarrja e rrezikut në mjedisin e punës (qoftë në vetëpunësim ose punësim në *start-up*-e), duke përdorur aftësitë e nevojshme për sukses në atë mjedis dhe kulturë. Ky përkufizim supozon se duke marrë vendimin për të nisur një biznes, të rinjtë po zhvillohen dhe po përdorin plotësisht aftësitë e tyre, vetëm ose në grup; të rinjtë përcaktojnë problemet e tyre, identifikojnë zgjidhje dhe gjejnë burime për të realizuar vizionin e tyre; dhe të rinjtë po realizojnë potencialin dhe vizionin e tyre, duke rritur vetëbesimin dhe duke marrë role aktive në komunitetet e tyre (Chigunta, 2002).

Ky hulumtim do të shqyrtojë klimën sipërmarrëse për të rinjtë për të hyrë në biznes, procedurat e vetëpunësimit dhe mendësinë e përgjithshme të të rinjve në aspektin e sipërmarrjes në Tivar, Podgoricë dhe Tuzi. Temat janë produkt i aktiviteteve të projektit që synojnë krijimin e kushteve për vetëpunësim më të mirë të të rinjve në zonën e tre bashkive në Mal të Zi dhe qarkun e Shkodrës në Shqipëri. Të dy raportet janë rezultat i aktiviteteve kërkimore të dy metodologjive të ndryshme që janë të njëjta për sa i përket temës dhe objektivave të kërkimit. Pala malazeze përdori metodën e analizave cilësore përmes intervistave individuale dhe realizimit të fokus grupeve në zonën e tri njësive të vetëqeverisjes vendore, komunat e Podgoricës, Tuzit dhe Tivarit. Këto analiza u paraprinë nga një analizë e kuadrit strategjik dhe ligjor, por edhe nga një analizë e të dhënave dytësore si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë lokal.

STUDIMI I VETËPUNËSIMIT, RINISË DHE SIPËRMARRJES NË MAL TË ZI

Pyetja thelbësore e studimit e nxjerrë nga analiza të mëparshme

Bazuar në njohuritë e mëparshme dhe rishikimin e literaturës, është e rëndësishme të theksohen pyetjet që ne i konsiderojmë qendrore kur bëhet fjalë për temën e vetëpunësimit dhe sipërmarrjes së të rinjve. Me këtë hulumtim do të përpiqemi të marrim njohuri për pyetjet e mëposhtme: Pozita e të rinjve në shoqëri? Përshkrimi i klimës sipërmarrëse për të rinjtë për të hyrë ose për të filluar biznesin — Perspektivat për biznes të mëtejshëm apo fillimin e një *start-up* - i? Çfarë i mungon stafit të ri (mungesa e aftësive, iniciativave, disa aftësive karakteristike)? Qëndrimi ndaj inovacionit (p.sh. Sa hapësirë ka për avancimin digjital, industrinë kreative)? Zhvillimi i *Freelancing* (profesione të pavarura) në fushën e hulumtuar - zhvillimi i produktit përmes *start-up*-eve (A e projektojnë veten të rinjtë në këto punë?) Zhvillimi i *outsourcing* (nënkontraktimeve)? Procedurat e vetëpunësimit dhe opinioni i përgjithshëm i të rinjve për të? Punë të dëshirueshme, premtuese dhe jo premtuese? Hendeku i brezave midis brezave të rinj dhe të vjetër për sa i përket sipërmarrjes? Mbështetja institucionale dhe barrierat për të rinjtë kur bëhet fjalë për sipërmarrjen? Mbështetja e komunitetit lokal? Mbështetja e sistemit arsimor në nivel kombëtar dhe lokal? Grupimet dhe bashkëpunimi - krijimi i zinxhirëve në prodhim? Cilat produkte importohen dhe mund të jenë pika e lidhjes ndërmjet rajoneve? Qarku i Shkodrës – Vendi për bashkëpunim në sipërmarrje (mungesa e profileve profesionale, gatishmëria e punëdhënësve dhe e të rinjve për të shkëmbyer mes dy rajoneve)?

Përgjigjet do të bazohen në analizën e kuadrit legjislativ dhe strategjik, analizën e të dhënave dytësore dhe përvojën dhe njohuritë e të anketuarve, qoftë të sipërmarrësve të rinj dhe atyre që janë në atë proces apo të palëve të interesuara, bazuar në jetën e tyre të përditshme dhe njohuritë e mbledhura nga perspektiva personale.

Kuadri legjislativ dhe strategjik në nivel kombëtar

Rishikimi i kuadrit strategjik dhe legjislativ të Malit të Zi në fushën e arsimit dhe sipërmarrjes së të rinjve të jep përshtypjen e përpjekjeve të ligjvënësit për të krijuar politika që synojnë një perspektivë më të mirë të të rinjve në Mal të Zi në lidhje me procesin e punësimit. Kuadri legjislativ kombëtar që kemi gjetur të rëndësishëm në këtë drejtim gjendet në dokumentet e mëposhtme: Strategjia për të mësuarit e sipërmarrjes gjatë gjithë jetës 2015-2019, Strategjia për Rininë 2017-2021 me Planin e Veprimit për 2017, Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Profesional 2015-2020, Strategjia Zhvillimore për Mikro Biznesin dhe Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme në Mal të Zi 2018-2022, Ligji për Rininë, Programi i Reformës Ekonomike për Malin e Zi 2021-2023, Drejtimet e zhvillimit për Malin e Zi 2015-2018.

Politika rinore e bazuar në Ligjin për Rininë e Malit të Zi zbatohet nga: Qeveria e Malit të Zi, organet e administratës shtetërore dhe organet e tjera administrative përgjegjëse për fusha të caktuara me fokus të rinjtë, bashkia, kryeqyteti, organizatat joqeveritare dhe subjektet e tjera të përfshira në planifikimin, zbatimin dhe përmirësimin e politikës rinore (Parlamenti i Malit të Zi, 2019). Në nivel kombëtar, institucioni më i rëndësishëm në fushën e politikave rinore është Drejtoria për Rininë dhe Sportin, e cila miraton planin vjetor të zbatimit të Strategjisë për Rininë dhe kryen kërkime për nevojat dhe pozicionin e të rinjve të paktën një herë në pesë vjet. Gjithashtu, Ligji për Rininë parashikon që për të nxitur dhe përmirësuar zhvillimin e politikës rinore, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të saj, si dhe përmirësimin e pozitës së të rinjve, organi i administratës shtetërore përgjegjës për arsimin formohet nga Këshilli Rinor, si organ profesional dhe këshillimor. Në këtë mënyrë, kuadri institucional për të rinjtë përmbledhet në dy institucione, fushëveprimi i të cilave shkon nga sporti në arsim.

Strategjia Rinore e Malit të Zi 2017-2021 (Ministria e Arsimit e Malit të Zi, 2017) identifikon disa fusha që janë vendimtare kur bëhet fjalë për sipërmarrjen dhe vetëpunësimin e të rinjve. Sipas kësaj strategjie, rezultatet kryesore do të nënkuptonin që të rinjtë të arrijnë sigurinë ekonomike dhe sociale përmes aksesit të lehtësuar në tregun e punës dhe punësimit, si dhe përmes një procesi cilësor. Në këtë drejtim, kur bëhet fjalë për punësimin e të rinjve, strategjia propozon masa që synojnë përmirësimin e besimit në procesin e punësimit, mbështetje më të madhe për të rinjtë në zhvillimin e sipërmarrjes, këshillimin për karrierën dhe shërbimet mbështetëse dhe rritjen e aktiviteteve për të rinjtë. Nga ana tjetër, arsimi duhet të mbështesë idenë që synon promovimin e arsimit joformal dhe verifikimin e tij nga autoritetet shtetërore.

Strategjia Sipërmarrëse e Arsimit të të Rriturve të Malit të Zi 2015-2025 (Ministria e Ekonomisë, 2019) ka përmirësuar në mënyrë strategjike një mjedis për përfshirjen e qytetarëve në procesin e të mësuarit gjatë gjithë jetës me qëllim zhvillimin e një

ekonomie konkurruese tregu, uljen e papunësisë dhe përjashtimin social. Fokusi në të mësuarit gjatë gjithë jetës duhet të mundësojë krijimin e kushteve për mobilitet dhe konkurrencë në procesin e integritit evropian. Dhe kjo strategji propozon masa në edukimin për sipërmarrje në të gjitha nivelet e arsimit formal dhe formimin e vazhdueshëm të mësuesve për kompetencat kyçe për sipërmarrjen në mënyrë që të përfshihen të gjithë mësuesit në të gjitha nivelet e arsimit. Strategjia promovon gjithashtu harmonizimin e politikës së regjistrimit në arsim me nevojat e tregut të punës si dhe zhvillimin e kompetencave, njohurive dhe aftësive sipërmarrëse përmes organizimit të moduleve të trajnimit për grupe të ndryshme të synuara duke përfshirë të rinjtë, sipërmarrësit potencialë, sipërmarrësit e rinj. Në fund, strategjia thekson rëndësinë e fushatës për promovimin e sipërmarrjes tek të rinjtë si dhe mënyrën e përdorimit të programeve në dispozicion për të mbështetur financiarisht sipërmarrjen rinore.

Në një rrugë të ngjashme dhe me parime të ngjashme, strategjia e zhvillimit të arsimit profesional i vendos parimet e saj sipas nevojave të tregut të punës, kështu që sistemi arsimor malazez ka kaluar nga programet arsimore të orientuara drejt përmbajtjes në programet arsimore të orientuara drejt objektivave. Kjo nisi procesin e përshtatjes së programeve arsimore me nevojat e tregut të punës, synimet e të cilave janë të harmonizuara për nevojat e ekonomisë (Ministria e Arsimit, Shkencës, Kulturës dhe Sportit, 2015). Gjithashtu, kjo strategji thekson rëndësinë e promovimit të mësimit të sipërmarrjes, i cili u prezantua në vitin 2002 në shkollat profesionale të Malit të Zi, por edhe nevojën e zgjerimit të fushës së lëndës dhe përtej drejtimit ekonomik dhe tregtar, gjë që do t'i jepte kësaj lënde një karakter më detyrues. Këtu është e rëndësishme të përmendet Ligji për Kualifikimet Profesionale Kombëtare (Ministria e Arsimit, Shkencës, Kulturës dhe Sporteve, 2018), i cili i hapi rrugën njohjes së njohurive të marra në mënyrë informale dhe lidhjes me këto njohuri, duke u mundësuar të rriturve pa arsimim formal njohuritë e duhura, të jenë në gjendje të provojnë këto njohuri dhe të marrin një dokument publikisht të vlefshëm për kualifikimin profesional kombëtar.

Përveç përparimit arsimor të strategjive të ndryshme, është e rëndësishme të përmendet kuadri strategjik i Malit të Zi që lidhet me zhvillimin ekonomik. Në këtë pjesë janë të pashmangshme përmbajtja e Strategjisë për Zhvillimin e Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme 2018-2022, si dhe Programi i Reformave Ekonomike për Malin e Zi 2021-2023.

Rëndësia e strategjive të sipërmarrjeve mikro dhe të mesme vjen nga fakti se ato bazohen në nevojat reale, sepse ky sektor në Mal të Zi përbën rreth 99 për qind të sipërmarrjeve dhe punëson 75 për qind të të punësuarve, duke kontribuar kështu ndjeshëm në rritjen e produkteve sociale, krijimin e vendeve të punës dhe uljen e papunësisë. Sipërmarrjet mikro, të mesme dhe të vogla janë burim i novacionit dhe rritjes së konkurrencës në tregun vendas me ndikim dhe rol të fortë për një zhvillimin më të balancuar rajonal. Për këtë arsye, strategjia e përmendur po bën përpjekje të mëdha për të krijuar kushte për përmirësimin e ambientit të biznesit të rekomandimeve në kuadër të "Gjytinës së Rregulloreve", e cila kishte për qëllim lehtësimin e biznesit të NVM-ve. Për shembull, regjistrimi i një kompanie është thjeshtuar dhe kryhet në një vend (One stop shop), me paraqitjen online të aplikimeve për regjistrimin e biznesit, përmes portalit *eGovernment* (Qeveria e Malit të Zi, 2018). Gjithashtu, një nga synimet strategjike të kësaj strategjie është përmirësimi i aksesit në financa dhe aksesit në kredi dhe forcimi i kapaciteteve të NVM-ve për përmirësimin e financave. Në këtë drejtim, Fondi për Investime dhe Zhvillim i Malit të Zi ka përmirësuar nga viti në vit mbështetjen kreditore për NVM-të dhe sipërmarrësve me theks të veçantë tek të rinjtë, gratë në biznes dhe fillestarët, prodhuesit bujqësorë, për projekte në fushën e infrastrukturës, energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit. Së fundi, kur bëhet fjalë për këtë strategji, është e rëndësishme të theksohet se një nga synimet strategjike është që të ndihmohen të rinjtë për të filluar një biznes, ndaj për këto nevoja, përveç financiare, ofrohet edhe mbështetje në infrastrukturë me theks të veçantë në aktivitetet rajonale, për shembull në veri të vendit.

Qeveria e Malit të Zi kreu përmes një programi ekonomik një analizë të projeksionit të treguesve makroekonomikë për periudhën 2021-2023. Kjo analizë supozon një rikuperim të pjesshëm të aktivitetit ekonomik si dhe një rikthim në nivelet e para krizës dhe rritje të mëtejshme ekonomike bazuar në pritshmëritë se në gjysmën e parë të vitit 2021 kërcënimi i pandemisë do të reduktohet ndjeshëm, ndërsa në të njëjtën kohë do të fitohet një imunitet kolektiv, me një numër të madh vaksinash. Baza e kësaj ofron bazën për rikuperim dhe rritje më të shpejtë në vitin 2021 dhe në vitet në vijim. Disa nga masat kryesore të propozuara nga kjo strategji bazohen në forcimin e konkurrencës së ndërmarrjeve mikro të vogla dhe të mesme si dhe aksesin e tyre në tregje të reja. Sipas raportit të SBA për vitin 2019 (OECD, 2019), kuadri strategjik më i konsoliduar e pozicionon Malin e Zi mbi mesataren e Ballkanit Perëndimor dhe të Turqisë në fusha të tilla si të mësuarit sipërmarrës, sipërmarrja e grave, krijimi i një kuadri institucional dhe rregullator për zbatimin e politikës së zhvillimit, dhe ofrimi i shërbimeve për NVM. Megjithatë, siç thekson programi i reformave ekonomike, është e nevojshme të regjistrohen rezultate më të mira edhe në drejtime të tjera. Nën mesataren janë fusha të tilla si aftësitë për NVM, inovacioni dhe promovimi i eksportit. Në këtë drejtim, hyrja në tregje të reja do të ishte një faktor kyç në tejkalimin e problemeve të një tregu të vogël (Qeveria e Malit të Zi, 2021).

Analiza e politikave në nivel lokal në Podgoricë, Tuz dhe Tivar

Kur bëhet fjalë për njësitë e vetëqeverisjes lokale, ato krijojnë dhe zbatojnë politika lokale rinore. Instrumentet e tyre kryesore janë Strategjitë e Bashkisë për Rininë ose Planet Lokale të Masave për Rininë. Sipas Ligjit për Rininë (Parlamenti i Malit të Zi, 2019), krahas strategjisë kombëtare, janë miratuar edhe Strategjitë e Bashkive për Rininë për zbatimin e politikës rinore. Gjithashtu, me qëllim koordinimin, planifikimin dhe zbatimin e politikës për rininë dhe bashkëpunimin e organeve kompetente të bashkisë me subjektet e tjera të politikës për rininë, bashkitë në kuadër të organeve apo shërbimeve të tyre mund të organizojnë njësi të veçantë organizative për të rinjtë (Zyra për Rininë dhe Këshilli Lokal për Rininë si organ i pavarur dhe këshillues i formuar nga organi kompetent i bashkisë), me qëllim inkurajimin dhe përmirësimin e zhvillimit të politikave rinore, monitorimin dhe vlerësimin e strategjisë së bashkisë (Parlamenti i Malit të Zi, 2019). **Tabela 1.** paraqet përmbajtjen institucionale të nivelit lokal të tri bashkive — Tivarit, Podgoricës, Tuzit.

Nga tabela shihet se të gjitha bashkitë që kanë qenë objekt i analizës sonë kanë Plane Lokale të Veprimit për Rininë - Podgorica ka përvojë më të gjatë, ndërsa Tuzi dhe Tivari kanë një të tillë vetëm që nga viti 2020. Gjithashtu, asnjë bashki nuk ka zyrë përfaqësie për Rininë por në mënyrë indirekte funksionet e tyre realizohen përmes organeve të tjera të bashkisë në nivel bashkie. Është interesante se asnjë nga bashkitë që kemi analizuar nuk ka një Këshill Rinor, në fakt ka zyrtarisht në Podgoricë (Parlamenti i Podgoricës, 2020) por nuk kemi gjetur gjurmë të aktiviteteve të tij, ndërsa në Tivar dhe Tuzi, Plani Lokal i Veprimit për Rininë parashikon formimin e Këshillit Rinor në periudhën në vijim (Bashkia e Tivarit, 2019).

TABELA 3: PËRMBAJTJA INSTITUCIONALE E KOMUNAVE TIVAR, PODGORICË DHE TUZI

	Plani i Lokal i Veprimit për Rininë	Zyra për Rininë	Këshilli Rinor	Këshilli Rinor Vendor	Klubi ose Qendra Rinore
Tivari	2020-2021	Sekretariati për Veprimtaritë Sociale	JO	JO	JO
Podgorica	2020-2021	në kuadër të Sekretariatit për Sipërmarrjen	PO	PO	PO
Tuzi	2020-2021	Sekretariati për Vetëqeverisje Vendore	JO	JO	JO

Sipas studimit të bërë bashkia e Podgoricës për nevojat e Planit të Veprimit për Rininë, vërehet një pasivitet i caktuar i të rinjve sepse 23% janë shprehur se nuk mendojnë për punësim dhe 25% e mendojnë ndonjëherë (Bashkia e Podgoricës, 2019). Ata identifikuan se burimet kryesore të këtij problemi janë mungesa e informacionit. Për këtë arsye, bashkia e Podgoricës ka intensifikuar aktivitetet në fushën e vetëpunësimit dhe ato realizohen nga Sekretariati për Sipërmarrje, ndërsa brenda Zyrës së Kryetarit të Bashkisë funksionon Byroja për Mbështetjen e Komunitetit të Biznesit. Çdo vit nga buxheti i qytetit ndahen 100 mijë euro për kreditimin e projekteve në fushën e bujqësisë dhe sipërmarrjes. Në tre vitet e fundit, rreth 250 persona kanë shfrytëzuar shërbimet e Qendrës së Këshillimit të Biznesit për Gra dhe të Rinj, të organizuar nga Byroja për Mbështetjen e Komunitetit të Biznesit në partneritet me Shoqatën e Grave Sipërmarrëse të Malit të Zi. Çfarë është inkurajuese kur bëhet fjalë për të dhënat në nivel të bashkisë së Podgoricës është se 54% e të anketuarve përmes studimit e shohin të ardhmen e tyre në biznesin e tyre. Në këtë drejtim, bashkia e Podgoricës ka ofruar shërbime kontabiliteti falas për tridhjetë shoqëri biznesi të reja në vitin e parë të funksionimit, si dhe rimbursimin e shpenzimeve të themelimit. Gjithashtu, është e mundur të hartohet një plan biznesi falas sipas metodologjisë së Fondit për Investimet dhe Zhvillimin ose nga Zyra e Punësimit. Është e rëndësishme të përmendet se kryeqyteti i Podgoricës dhe Unioni i Punëdhënësve të Malit të Zi kanë krijuar një Qendër Kompetencash (Bashkia e Podgoricës, 2019).

Për sa i përket bashkisë së Tivarit, ajo ka kryer një anketim për identifikimin e nevojave të Planit të Veprimit për Rininë, e cila tregon se, për shembull, një përqindje e madhe e të rinjve (60%) nuk janë të kënaqur me perspektivat e tyre në këtë bashki dhe deklarojnë mungesën e mundësive të mjaftueshme për zhvillim dhe arsim si arsye kryesore për situatën (Bashkia e Tivarit, 2019). Gjithashtu, një përqindje e madhe e të anketuarve, 80%, besojnë se nuk do të gjejnë punë në një të ardhme të afërt dhe si zgjidhje për tejkalimin e kësaj situatë, të rinjtë sugjerojnë përmirësimin e transparencës së institucioneve, qasjen në informacion dhe zhvillimin e sipërmarrjes (Bashkia i Tivarit, 2019). Brenda strukturës së bashkisë së Tivarit, për nevoja të realizimit të

problemeve të punësimit, funksionon njësia rajonale e Zyrës së Punësimit të Malit të Zi-Zyra e Punës, në të cilën përfshihet Qendra për Informim dhe Këshillim Profesional. Përveç ZZCG, në kuadër të fuqizimit ekonomik dhe promovimit të mendimit sipërmarrës punojnë edhe institucionet arsimore, ndaj edhe Qendra e Sipërmarrjes është aktive në kuadër të Shkollës së Mesme Ekonomike, si një model i veçantë i mbështetjes edukative dhe motivuese të të rinjve për të forcuar potencialin e tyre për zhvillimin e sipërmarrjes private. Megjithatë, mungon përkrahja më e fortë institucionale dhe financiare, si në nivelin e bashkisë së Podgoricës, edhe në nivelin e rinisë.

Në Bashkinë e Tuzit, për nevojat e zbatimit të planit lokal të veprimit për të rinjtë, është kryer edhe një studim por nuk kemi gjetur të dhëna sepse nuk kanë qenë pjesë e planit të veprimit në dispozicion. Kur bëhet fjalë për fushën e sipërmarrjes, plani lokal i veprimit, në përputhje me mundësitë e bashkisë, parashikon burime modeste financiare për realizimin e objektivit në aspektin e sipërmarrjes. Për shembull, propozohen masa për organizimin e vizitave në panaiet e punësimit, mbështetjen e sipërmarrjes në shkolla, organizimin e trajnimeve me temën e sipërmarrjes. Buxheti total i bashkisë së Tuzit për këtë pjesë të planit të veprimit është 1000 euro (Bashkia e Tuzit, 2019). Vetë struktura e papunësisë në këtë bashki është pikëlluese sipas të dhënave të vitit 2011 (nga censusi i Malit të Zi) duke dëshmuar se grupi më joaktiv i të papunëve janë amvisat. Një problematikë e madhe e treguesve sasiorë në këtë bashki për sa i përket sipërmarrjes është se një pjesë e konsiderueshme e komapnive nuk i kanë ndryshuar të dhënat në aplikacionet e tyre dhe ende nuk është vendosur monitorimi statistikor i numrit të të punësuarve për bashkitë e sapoformuara (Bashkia e Tuzit, 2021). U vu re se në strukturën e të papunëve sipas kohëzgjatjes së kërkimit të punës, papunësia afatshkurtër është 45.4%, ndërsa papunësia afatgjatë (personat që kërkojnë në mënyrë aktive punë mbi 12 muaj) përbën 54.6% të të papunëve. Një nga konkluzionet e rëndësishme të analizës së kryer nga bashkia e Tuzit është se me rritjen e kohëzgjatjes së papunësisë zvogëlohet probabiliteti për të gjetur një vend pune, pasi njohuritë dhe aftësitë bëhen të tejkaluara gradualisht me kalimin e kohës (Bashkia e Tuzit, 2021).

Analiza dytësore e të dhënave - tendencat dhe perspektivat e vëzhguara

Sipërmarrja rinore në Mal të Zi dhe procesi i vetëpunësimit karakterizohen nga sfida të shumta, të cilat në një mjedis të ndryshuar nga pandemia aktuale i kanë ekspozuar dukshëm të gjitha mangësitë e saj, por kanë vënë në dukje edhe tendenca të caktuara të të ardhmes. Kështu, industria kulturore dhe krijuese, si dhe industria digjitale, sapo kanë dëshmuar të jenë një nga degët më elastike të ekonomisë, duke përqafuar të gjitha avantazhet e punës nga shtëpia dhe blerjeve përmes internetit. Kjo funksionon për një brez të rinjsh që nuk i fitojnë aftësitë e tyre në biznes zyrtarisht, por në trajnime formimi, përmes përvojës në biznes, etj. Mund të shërbejë si një shtysë e re për zhvillimin ekonomik që në një mënyrë shumë më të veçantë dhe efikase mund të përballohen të gjitha vështirësitë ekonomike të pas tranzicionit pa përfshirë angazhimin më të madh të aktorit shtetëror si bartës i këtyre projekteve.

Megjithatë, duke rishikuar kërkimet në këtë fushë, u vëzhgua një problemi i dyanshëm. Konkretisht, nga njëra anë, të rinjtë e portretizojnë papunësinë e tyre si rezultat i disa faktorëve objektivë, siç janë mangësitë sistematike në tregun e punës, e jo si rezultat i mangësive të tyre në aspektin e motivimit, sepse vetëm 5.4% e të rinjve treguan se nuk duan të punojnë. Pra, në lidhje me ato të dhëna nuk është arsyeja e mosgatishmërisë së tyre për të punuar, por diçka tjetër, dhe vetëm 4.6% besojnë se arsyeja e papunësisë së tyre është se u mungojnë aftësitë apo kualifikimet e duhura (Forum Mali i Zi, 2020). Nga ana tjetër, kur bëhet fjalë për mendimin e punëdhënësve, mendimi i tyre është se pengesa kryesore për punësimin e të rinjve është pikërisht mungesa e aftësive, njohurive dhe përvojës që ata nuk kanë ose nuk e kanë marrë me profesionalizëm të përcjellë nga procesi arsimor (CGO, 2017).

Problemi i hendekut të përmendur të brezave, i dukshëm në bazë të perceptimit të dy brezave, mund të jetë një sfidë e madhe në tejkalimin e problemit të punësimit të të rinjve, veçanërisht duke marrë parasysh karakteristikat sociologjike të shoqërisë malazeze - anonimiteti, arroganca e të rinjve dhe mbizotërimi i modeleve tradicionale. Gjithashtu, prirja për polarizim mund të jetë një faktor shtesë që nuk duhet anashkaluar në aktivitetet e ardhshme strategjike në këtë fushë.

Kur bëhet fjalë për arsimimin e të rinjve, në Mal të Zi ky ka qenë objekt i studimeve të shumta deri më tani. Kështu, për shembull, një nga hulumtimet e bëra në këtë fushë tregon se i ashtuquajtimi mjedisi kulturor luan një rol të madh në procesin e arsimimit. Kjo do të thotë se një person ka më shumë gjasa të jetë më i arsimuar pasi anëtarët e familjes në të cilën ai rritet janë të arsimuar (Đukanović, 2019). Kjo do të thotë se mjedisi i përgjithshëm i socializimit të të rinjve ndikon shumë në zhvillimin e mëtejshëm të karrierës së tyre dhe mjedisi familjar luan rol jetik (por jo i vetmi) në arritjet e mëtejshme profesionale të jetës.

Një tjetër konstatim interesant kur bëhet fjalë për studimet e të rinjve dhe preferencat e tyre për punësim është preferenca për të ashtuquajturat “punë në administratë shtetërore”. Përkatësisht, më shumë se gjysma e qytetarëve malazezë (popullsia totale) besojnë se të rinjtë preferojnë një punë në administratë shtetërore (60%) ndërsa vetëm 16% besojnë se duhet të vetëpunësohen dhe të drejtojnë biznesin e tyre (CGO, 2017). Ky qëndrim është edhe më i theksuar tek të rinjtë, sepse kërkimi për të rinjtë për këtë çështje (nënkampioni i popullatës rinore) dëshmon se rreth 71.5% e tyre preferojnë të punojnë në sektorin publik (CGO, 2017). Kjo e dhënë është edhe më befasuese sepse kërkimi në grupet përfaqësuese tregon se vetëm një numër i vogël i qytetarëve të rinj (12.6%) kanë kontratë punësimi të përhershme (Đukanović, 2019). Kjo situatë mund të shkaktohet nga njëra anë nga zakonet pas tranzicionit të krijuara nga transmetimi i modeleve të punës nga një brez në tjetrin ose si një rrugëdalje nga kriza e punësimit duke krijuar një vend pune me një perspektivë më të sigurt. Sigurisht, kjo frikë nga papunësia e përhershme është e justifikuar dhe zgjidhja dominuese e “punëve në administratë shtetërore” justifikohet sepse mbi 50.0% e të anketuarve kanë qenë të papunë për më shumë se një vit ose nuk kanë punuar kurrë (Forum MNE, 2020).

Një karakteristikë e rëndësishme e një shoqërie me shkallë të lartë papunësie më së shpeshti ndikon në problemin e deprofesionalizimit dhe më së shpeshti nënkupton pranimin e vendeve të punës për të cilat ata persona nuk janë arsimuar dhe kjo më së shpeshti sjell degradimin e profesioneve (Đukanović, 2019). Ky problem shoqërohet me korrupsion dhe nepotizëm të theksuar në realizimin e procesit të punësimit, i cili po bëhet jo vetëm një mënyrë e pëlqyeshme, por edhe një strategji gjithnjë e më shpeshtë.

Rruga për të dalë nga ky problem duhet parë sigurisht në zgjidhjet alternative dhe si një nga të mundshmet sigurisht që imponohet në drejtim të pavarësisë dhe fillimit të biznesit. Pikërisht një zgjidhje e tillë mund të ofronte një alternativë ndaj modelit dominues, por do të kërkonte edhe progres të vijueshëm në procesin e trajnimit dhe edukimit të mëtijshëm. Kjo situatë vërehet në studimin e kryer nga Qendra për Edukim Qytetar (2017), ku numri më i madh i qytetarëve theksuan se perspektiva e mëtijshme e të rinjve sa i përket punësimit është krijimi i kushteve më të mira për sipërmarrësit, kreditimi më i mirë, mbështetja nga bankat dhe mjedisi i biznesit.

Të gjithë treguesit para krizës aktuale dhe madje edhe tendencat gjatë kohëzgjatjes së saj tregojnë se aftësitë digjitale do të vlerësohen jashtëzakonisht shumë në tregun e punës. Kjo duhet të përfshijë një gatishmëri për digjitalizimin e ardhshëm dhe të gjitha ndryshimet që ai gjeneron. Arsimi duhet të ndjekë këtë tendencë dhe raporti i UNDP-së për të ardhmen digjitale për të gjithë thekson nevojën e ndryshimit të kurrikulës shkollore, e cila do të synonte zhvillimin e të menduarit kritik, si dhe njohuritë dhe aftësitë e nevojshme bazuar në arritjet e shkencës, teknologjisë dhe shoqërisë (UNDP, 2020). Kjo duhet të shoqërohet edhe me harmonizimin e tregut të punës dhe furnizimin e fakulteteve dhe shkollave të mesme. Për shembull, profesionet në fushën e turizmit, të cilat janë një nga profesionet më të begata dhe më të shpeshta në Mal të Zi, si dhe profesionet në administratën publike për shkak të automatizimit të madh të detyrave të punës do të kërkojnë gjithnjë e më pak kapital njerëzor - p.sh. në vitin 2019, e gjithë oferta e arsimit të lartë në Mal të Zi ishte 2.9 herë më e lartë se kërkesa (UNDP, 2020). Ky duhet të jetë një paralajmërim për të gjithë politikëbërësit në fushën e punësimit të të rinjve, sepse çdo vit numri i të rinjve që regjistrohen në fakultete, orientimi profesional i të cilëve më vonë shkon drejt turizmit apo administratës publike është shumë më i lartë se sa duhet.

Të gjithë këta faktorë duhen parë si një paralajmërim sepse është e rëndësishme të krijohen kushte dhe parakushte për një klimë më të mirë sipërmarrëse në Mal të Zi. Studimi i fundit i Unionit të Sindikatave të Lira tregon për pozitën e palakmueshme të të rinjve në Mal të Zi, në të cilin gjendja aktuale është qartësisht e dukshme dhe mund të parashikohen disa tendenca të së ardhmes. Në mënyrë specifike, të dhënat nga ky studim tregojnë se 67.3% e të rinjve planifikojnë të largohen në një moment të dytë nga Mali i Zi në kërkim të një pune më të mirë. Gjithashtu, ky studim jep një pasqyrë të qartë të situatës në Mal të Zi ku 33.8% e të punësuarve po planifikojnë seriozisht të largohen nga Mali i Zi për të punuar dhe jetuar jashtë vendit për shkak të pagave më të larta dhe kushteve të mira të punës, 15% të tjerë janë vetëm duke menduar për këtë, 51.2% e të punësuarve kanë kontrata me afat të caktuar ose për punë të rastit dhe të përkohshme, ndërsa 40.9% e të punësuarve nuk përfitojnë kompensim për punë jashtë orarit, 30.3% janë të regjistruar për më pak se paga reale, punonjësit në Mal të Zi kanë një pushim mesatar vjetor shtatë ditë më pak se sa minimumi ligjor, siç dëshmohet nga një pamje tërthore e rezultateve të anketimit (Kapor, 2021).

Analiza e të dhënave të mbledhura përmes intervistave dhe fokus grupeve

Më poshtë do të përmbledhim gjetjet e marra nga mbledhja e të dhënave përmes intervistave dhe fokus grupeve. Për sa i përket intervistave, morën pjesë 12 pjesëmarrës nga institucionet, nga vetëqeverisja vendore, nga sistemi arsimor dhe realizuam dy fokus grupe që kishin gjithsej 10 pjesëmarrës - njëri me sipërmarrës të rinj dhe tjetri me të rinj të papunë. Mbledhja cilësore e të dhënave është realizuar në periudhën prej 7 qershorit deri më 5 korrik 2021 në tri bashkitë e Podgoricës, Tuzit dhe Tivarit. Bazuar në të dhënat e marra dhe sistematizimin e informacionit në grupe, gjetjet nga kjo pjesë e hulumtimit do të përmbledhen në katër pjesë.

Pozicioni i të rinjve në shoqëri

Të dhënat e sipërpërmendura nga analiza dytësore si dhe të dhënat e marra nga planet lokale të veprimit flasin për polarizimin e të rinjve sa i përket pozicionit dhe ndërgjegjësimit të tyre. Nga njëra anë, ka nga ata që mund të klasifikohen si pasivë dhe që shpesh nuk e ushtrojnë të drejtën e punës, por e fitojnë atë më vonë. Kjo kategori i afrohet atyre të rinjve që ose presin një vend pune në administratën publike, sepse ky punësim përcjell një lloj sigurie, ose zakonisht e ushtrojnë atë të drejtë “nëpërmjet lidhjes”. Milena Gaćina, përfaqësuese e bashkisë së Tivarit, theksoi se trashëgimia socialiste është një barrë e madhe, e cila i ofronte individit zgjidhje sistematike që ishin më cilësore se aktualet, prandaj përmes një nostalgjie të caktuar të trashëguar nevoja për një qasje e tillë sistematike është idealizuar në kontekstin aktual. Nga ana tjetër, është një grup i të rinjve që janë mjaft aktivë në procesin e punësimit dhe në atë grup bëjnë pjesë një numër i madh i atyre që kanë arritur rezultate me biznesin e tyre ose që po përpiqen të arrijnë. Për shembull, përfaqësuesit nga Unioni i Punëdhënësve, Marina Jovanović dhe Danilo Kaluđerović, theksojnë se ndërgjegjësimi i të rinjve po ndryshon ndjeshëm dhe se përvoja e tyre nga terreni konfirmon tezën se të rinjtë i tejkalojnë barrierat e së shkuarës dhe me guxim ndërmarrin disa iniciativa; ata deklarojnë të dhëna inkurajuese nga një studimi i kryer ku “50% e të rinjve marrin përsipër rrezikun dhe përgjegjësinë për dështimin, konkretisht e kthejnë gishtin nga vetja, që është tregues i mirë i vet-ndërgjegjësimit” (Jovanović, Kaluđerović, 2021).

Kriza aktuale e shkaktuar nga pandemia ka ekspozuar mangësitë sistemike dhe ka vënë në dukje tendencat e caktuara në biznes. Kështu, pjesëmarrësit e fokus grupeve theksuan se për një numër prej tyre, biznesi "lulëzoi" në atë periudhë, kushtet e krijuara nga situatat pandemike ishin të përshtatshme për hedhjen e disa produkteve në treg dhe pjesa më e madhe e komunikimeve digjitale tejkaloi kushtet e izolimit. Nga ana tjetër, goditjen më të madhe e pësuan ata që merren me industrinë e shërbimeve, veçanërisht në sektorin e turizmit.

Së fundmi, theksojnë bashkëbiseduesit, një problem madhor institucional që lind është se një numër i madh i të rinjve nuk janë në sistemin arsimor, në trajnimet e formimit apo zyrën e punësimit, rreth 30% sipas Danijela Vujošević nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Kulturës dhe Sporteve - kryesisht të gjitha të dhënat nga burimet qeveritare pasqyrojnë situatën në nivel lokal. Dhe nëse kësaj i shtojmë përqindjen që të rinjtë përbëjnë një pjesë prej rreth 22% në totalin e të papunëve, atëherë situata aktuale është më se shqetësuese (Jovanović, Kaluđerović, 2021). Për këtë arsye, para së gjithash është e rëndësishme që të ndryshohet supozimi dhe para së gjithash të vihet në funksion rinia, dhe kjo ka të bëjë me aftësitë dhe njohuritë që të rinjtë kanë. Shumica e bashkëbiseduesve pajtohen se veprimi është një problem i madh i sistemit tonë, sepse ne nuk njohim potencialin e të rinjve, por që në fillim fillojmë me një supozim sistematik për dobësinë që nuk lidhet me të rinjtë por me sistemin dhe menjëherë përgjithësohet kështu supozimi në të gjithë popullsinë e të rinjve.

Para së gjithash, është e rëndësishme që vlerat e përftuara në arsim të marrin potencialin e tyre të plotë, por edhe një përmirësim i bazës së njohurive në sistemin shkollor. Është e rëndësishme për të ndërtuar dhe për të ruajtur shpirtin sipërmarrës dhe entuziazmin e të rinjve deri në fund të shkollës dhe në vijim. Në këtë proces, roli i mësuesve në shkolla dhe mbështetja e mëvonshme e mentorimit pas dhe gjatë shkollimit nga punëdhënësit luajnë rol vendimtar. Është e rëndësishme që mësuesit të ndërtojnë potencialin e të rinjve, sepse, siç bashkëbiseduesit theksojnë, është mjaft sfiduese për të mbajtur gjallë interesin e të gjithëve në sipërmarrje, sepse, për shembull, në një klasë vetëm pak studentë janë realisht të interesuar në këtë drejtim (Vlahović, 2021). Pjesëmarrësit e fokus grupeve bien dakord që duhet konsideruar që jo të gjithë mund të angazhohen në sipërmarrje. Në këtë drejtim, një problem i madh është mungesa e të dhënave për numrin e të diplomuarve në arsimin e lartë të cilët kanë filluar bizneset e tyre, e dhënë që do të shërbente si një nxitje e mirë për të tjerët për të filluar sipërmarrje të ngjashme, bazuar në përvojën e tyre. Aleksandar Šipčić, përfaqësuesi i qeverisjes studentore nga FPN, vë në dukje se edhe modeli i ri i studimit nuk parashikon trajnime formimi profesionale për të diplomuarit: “Së paku është e diskutueshme se çfarë mund të pritët nga brezi i parë që përfundon modelin e reformuar të studimit kur të dalë në tregun e punës. Është gjithashtu e diskutueshme se çfarë mund të pritët nga brezi i dytë dhe çdo brez pasardhës, sepse është e qartë se tre vitet e formimit bazë dhe praktika e përftuar në modelin e reformuar të studimeve nuk mund të jenë një përgatitje cilësore dhe gjithëpërfshirëse për tregun e punës” (Šipčić, 2021). Ai më tej thekson se është e rëndësishme të krijohet një shërbim për studentëve që do të ketë rolin e një ndërmjetësimi midis studentëve, p.sh studentët (të cilët janë zbatuesit e punëve të caktuara) dhe punëdhënësit dhe

